

UNITED NATIONS
United Nations
Interim
Administration
Mission in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission
d'Administration
Interimaires des Nations
Unies au Kosovo

KUVENDI I KOSOVËS СЕПТИЛДЖИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

BULETINI

Nëntor, 2003 Nr.3



Zyra për Marrëdhënie me Media dhe Publikime e Kuvendit të Kosovës

Kryeparlamentari Daci priti delegacionin qeveritar të Luksemburgut

• **DACI:** Kemi resurse humane dhe natyrore për ta udhëhequr Kosovën

• **JUNCKER:** Duhet ecur në rrugën e Rezolutës 1244 të OKB-zë dhe të bashkëpunimit të institucioneve vendëse e ndërkombëtare




Talimi Daci - Juncker

Kryeministri i Luksemburgut në krye të një delegacioni të gjerë qeveritar, i shoqëruar edhe nga disa gazetarë, është pritur nga kryetari i Kuvendit të Kosovës, Nexhat Daci, i cili i ka njoftuar mysafinët me zhvillimet në Kosovë dhe synimet e popullit të Kosovës për liri, demokraci, zhvillim gjithpërfshirës dhe integrim në strukturat euroatlantike. Profësori Daci në takim me kryeministrin e Luksemburgut ka prezantuar edhe rregjet në Kosovë gjatë viteve të pasluftës, për shkak të të moskuptimit të rrafsheshëm të realitetit të ri të Kosovës dhe nevojave të popullit të saj. Ai, ndërkaq, ka vënë në spikamë se për zhvillimin e mbasë të Kosovës, pas ndihmës ndërkombëtare, nevojitet edhe bartja e kompetencave të institucioneve vendëse. Kemi resurse humane dhe natyrore për t'i marrë përgjegjësitë për udhëheqjen e Kosovës, ka theksuar Daci, i cili i ka vlerësuar si shumë të dobishme qëndrimet e shprehura nga zoti Grosman dhe Grupi i Kontaktit për çështjen e Kosovës.

Kryeministri i Luksemburgut Claude Juncker, është shprehur se ka adhur të mbledhë informacione, në funksion të krijimit të qëndrimit për Kosovën. Ai ka theksuar se për ardhmërinë e Kosovës është shumë e rëndësishëm zhvillimi i qetë dhe raportet e mira me mekanizmat ndërkombëtarë në Kosovë.

Kryeqeveritari i Luksemburgut ka theksuar se duhet ecur në rrugën e Rezolutës 1244 të OKB-së dhe të bashkëpunimit të institucioneve vendëse e ndërkombëtare.



PËRMBAJTJA:

Daci: Kemi resurse humane dhe natyrore për ta udhëhequr Kosovën	2
Shqyrtohet projektligji kundër diskriminimit.....	7
Është formuar grupi punues për ndryshimet dhe plotësimet e Kontrazës Kushtetuese	8
Kriza e një pjese të sistemit të drejtësisë dhe të gjyqësorit në Kosovë	12
Reformimi i sistemit zgjedhor në Kosovë dhe pozita e gruas	14
Aprovohen disa amendamente në Rregulloren e Punës së Kuvendit të Kosovës	20

Redaksia:

Sherif Konjufca, Shefqet Rexhepi, Celal Ilyas, Edona Fetahu

Telefonat Kontaktues:

038\ 211 186, 038\ 211 949, 038\ 211 189, 044\ 127 921

Tel/Fax: 038 211 188

E-mail:

media_kuvendi@hotmail.com

Është formuar grupi punues për ndryshimet dhe plotësimet e Kornizës Kushtetuese

Procesi i ndërrimit të Kornizës Kushtetuese është një qasje plotësisht realiste e këtij Kuvendi. Kjo nuk përjashton nevojën që ky Kuvend menjëherë të fillojë punën në përgatitjen e një kushtetute të re, kushtetutë kjo e cila do të jetë e gatshme në kohën kur Kosova do të jetë e gatshme për ta miratuar dhe për ta finalizuar edhe çështjen e implementimit të vullnetit politik të popullit të Kosovës

Në mbledhjen e 30 tetorit të këtij viti u shqyrtua Propozimi për krijimin e grupit punues për ndryshimet dhe plotësimet e Kornizës Kushtetuese. Duke dhënë në fillim një arsyetim të shkurtër të kërkesës së Qeverisë së Kosovës dhe të Komisionit për legjislacion, gjyqësi dhe çështje të Kornizës Kushtetuese, për ndërrimin e saj, **Arsim Bajrami**, kryetar i Komisionit tha se kjo nismë ka bazueshmëri të plotë kushtetuese në vetë Kornizën Kushtetuese, e cila në fakt e ka njohur të drejtën e këtij Kuvendi për të bërë ndryshime dhe plotësime përmes amendamenteve të Kornizës Kushtetuese.

Në anën tjetër, kjo nismë është plotësisht në frymën e vetë Kornizës Kushtetuese, e cila në preambulë dhe në disa dispozita kalimtare, parasheh që përgjegjësitë do të barten hap pas hapi nga institucionet ndërkombëtare te institucionet vendore dhe në një mënyrë vetë kjo Kornizë ka paraparë që në proces të ndryshohet, në mënyrë që të pasurohet vetëqeverisja substanciale dhe në fakt të ndihmohet edhe vetë UNMIK-u dhe administrata ndërkombëtare për ta realizuar misionin e administrimit ndërkombëtar në Kosovë.

Nuk ka tendenca për t'i marrë përgjegjësitë njëanshëm nga administrata ndërkombëtare

Kjo është më se e nevojshme për shkak se edhe në strukturat e UNMIK-ut, por edhe në opinionin e gjerë, ekziston një huti se me këtë veprim Kuvendi po bën diçka që nuk ka të drejtë apo po tenton për të

marrë njëanshëm përgjegjësitë. Mendoj se kjo nuk është një tendencë për t'i marrë përgjegjësitë njëanshëm nga administrata ndërkombëtare, por është një ofertë shumë konstruktive që Kuvendi i Kosovës po ia bën UNMIK-ut për t'i marrë kompetencat dhe për t'i realizuar me sukses përgjegjësitë e përbashkëta. Kështu që, në këtë kuptim, mendoj se do të kemi edhe mirëkuptim nga ana e UNMIK-ut, i cili nuk duhet të hezitojë që të realizojë misionin e vet në Kosovë, pra ta aftësojë vetë këtë popull, duke e ngritur kapacitetin e qeverisë së tij, ta aftësojë në mënyrë që të përgatitet finalizimi i implementimit të vullnetit politik të popullit të Kosovës në një fazë për të cilën do të vendosë vetë ky Kuvend.

Një reformë kushtetuese është mëse e domosdoshme për shkak se objektivi themelor i Kornizës Kushtetuese është realizuar. Objektivi themelor i kësaj Kornize ka qenë krijimi i bazës kushtetuese për ngritjen e institucioneve demokratike të Kosovës. Këto institucione janë ngritur dhe tani janë funksionale, me kufizimet kushtetuese që kanë. Por, mendoj se nuk është realizuar ajo që ka paraparë Rezoluta 1244, nuk është realizuar koncepti i vetëqeverisjes substanciale për Kosovën.

Duke pasur parasysh kufizimet që ka ky Kuvend, që ka Qeveria dhe institucionet tjera, mendoj se akoma jemi shumë larg konceptit të vetëqeverisjes substanciale. Me qëllim që të bëhet realitet, pra qeverisja substanciale kuptimplote është mëse e domosdoshme që t'i hyhet një reforme rrënjësore kushtetuese në

mënyrë që të ngriten dhe të forcohen kapacitetet qeverisëse të Kosovës.

Për momentin, mendoj se reforma kushtetuese pretendon tri qëllime kryesore:

Qëllimi i parë do të jetë të krijojë një bazë kushtetuese dhe ligjore për bartjen e përgjegjësisë.

Ju e dini që edhe Qeveria e Kosovës dhe Kuvendi i Kosovës, por mendoj edhe vetë UNMIK-u dhe Përfaqësuesi Special ka deklaruar që do ta fillojë procesin e bartjes së kompetencave.

Për të ndodhur një bartje substanciale e kompetencave, është e domosdoshme të krijohet baza kushtetuese.

Qëllimi i dytë i kësaj reforme kushtetuese është dhënia e mundësisë institucioneve të Kosovës për t'i përmbushur standardet ndërkombëtare, pra për të shënuar një progres rreth formulës – standardet para statusit.

Mendoj se me këto kompetenca që ka ky Kuvend, që ka Qeveria e Kosovës, ne nuk mund të bëjmë më tepër për standarde. Në qoftë se dëshirohet që vërtetë ne të dëshmojmë aftësinë tonë për t'i përmbushur këto standarde, duhet të na besohet më shumë dhe, në fakt, ne duhet të pasurohem me kompetenca të reja. Qëllimi i tretë është që t'i ndihmohet edhe vetë UNMIK-ut për ta finalizuar Rezolutën 1244, do të thojë, për ta përshpejtuar zgjidhjen e statusit final. E dimë të gjithë në këtë sallë që, një nga objektivat strategjike të UNMIK-ut dhe të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, është përshpejtimi i procesit të zgjidhjes finale të statusit të Kosovës dhe lehtësimi i këtij statusi.

[/ vijon në faqe 4 /](#)

Kjo do të ishte e mundshme vetëm në qoftë se tani Kosova rumbullaksohet me të gjitha kompetencat që i ka, të cilat në fakt nuk janë në kolizion me vetë prezencën ushtarake në Kosovë, do të thoja edhe me vetë prezencën civile.

Procesi i ndërrimit të Kornizës Kushtetuese është një qasje plotësisht realiste e këtij Kuvendi. Kjo nuk përjashton nevojën që ky Kuvend menjëherë të fillojë punën në përgatitjen e një kushtetute të re, kushtetutë kjo e cila do të jetë e gatshme në kohën kur Kosova do të jetë e gatshme për ta miratuar dhe për ta finalizuar edhe çështjen e implementimit të vullnetit politik.

çështja e implementimit të vullnetit politik të popullit të Kosovës dhe ne nuk do të kemi nevojë të presim dy apo tri vjet për ta pasur bazën kushtetuese, por ajo bazë kushtetuese duhet qysh tash, nga kjo përbërje e Kuvendit, të fillohet dhe të përgatitet.

Në vijim kryetari i Kuvendit të Kosovës, **Nexhat Daci** dhe disa informacione për deputetët duke theksuar se Kryesia, në dy mbledhje të saj, ka diskutuar, ka debatuar dhe njëzërit është përcaktuar për këtë hap. Prandaj, do t'i lutja diskutuesit – ne sot flasim vetëm për hapjen e procesit, për dhënien e lejes që Grupi punues dhe komisioni

Sabri Hamiti në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës theksoi se përkrahim inisiativën dhe mendojmë që , kjo ditë është kur duhet të mirret inisiativa, ose nisma për procedurën dhe për nevojat e ndërrimeve që janë të domosdoshme në Kornizën ekzistuese Kushtetuese, në mënyrë që të funksionojë jeta përgjithësisht në Kosovë, me hapat që ne i kërkojmë dhe që janë të domosdoshëm për qytetarët e Kosovës. Për këtë ekziston edhe rregullativa ekzistuese. Neni 14 i Kornizës Kushtetuese të Kosovës jep mundësinë qysh do të zhvillohen procedurat. Po ashtu , brenda Rregullores për punën e Kuvendit i kemi shumë sakt të për-



Pamje nga një seancë e Kuvendit të Kosovës

Për momentin, vlerësoj se është një politikë realiste, në qoftë se ne ndihmojmë procesin e përfundimit të misionit të UNMIK-ut në Kosovë, me marrje të përgjegjësive në rrugë legale. Por, ky Kuvend ka përgjegjësi që në mënyrë të pashtyeshme, të fillojë punën në hartimin e kushtetutës së re të Kosovës, e cila do të jetë e gatshme në momentin kur do të rumbullaksohet

përkatës i Parlamentit të Kosovës t'i marrin të gjitha autorizimet, ta angazhojë bazën e gjerë profesionale kombëtare dhe të kërkojë ndihmë ndërkombëtare. Ne jemi marrë vesh edhe për një çështje, që në këtë proces do të bashkëngjitet, dhe kemi kërkuar, edhe Zyra Ligjore e UNMIK-ut dhe ka pajtueshmëri për këtë.

caktuara metodat, mënyrën, punën rreth ndryshimeve të mundshme. Më në fund, ne kemi pasur ndryshime në këtë Kornizë edhe më herët, kështu që nuk është presedan.

Rreth kësaj pune, ne kemi në dorë një grup, quhet Grup punues, a po, që vjen si informatë nga Kryesia. Unë nuk kam kurrfarë vërejtjesh në emrat dhe përbërjen e tij. Por, në emër të Grupit Parlamentar të

Lidhjes Demokratike, unë mendoj se ky Komision duhet të bëhet me 7 anëtarë, është domosdo të jetë me 7 anëtarë - minimum. Dhe menjëherë, prap në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës, përkrah këtë përbërje dhe propozoj që të jetë në këtë Grup edhe zonja Nekibe Kelmendi, një juriste shumë e fortë dhe një deputete e nderuar e këtij Parlamenti.

Dragisha Kërstoviq tha se kjo nismë është shqyrtuar edhe në Komisionin e Kuvendit për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë kushtetuese, me ç'rast përfaqësuesit e bashkësisë serbe ishin kundër kësaj nisme, me arsyetim se Korniza kushtetuese ,tani për tani, është mjaftë e zbatueshme, se asgjë tjetër përveç bartjes së përgjegjësiive nuk është interesante dhe thënë thjeshtë, konsiderojmë se nuk është koha për një nismë dhe ndryshime të tilla në Kornizën kushtetuese.

Përveç tjerash, në Kornizën kushtetuese në Kreun 14 shkruan: se Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara duhet të ndër marrë masa të nevojshme që ta mundësojë bartjen e kompetencave dhe obligimeve në Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes dhe mendojmë se kjo flet mjaftë se Përfaqësuesi Special, sipas vlerësimit të vetë, kur ai ta vlerësojë, mund ta bëjë bartjen e përgjegjësiive në Institucionet e Përkohshme.

Në anën tjetër, mendoj se është mjaftë mirë që në pikën 14.3 shkruan se PSSP mundet, me nismë personale ose në bazë të kërkesës së përkrahur nga dy të tretat e deputetëve të Kuvendit, të nxjerrë amendamente në Kornizë kushtetuese. Unë jam i sigurt se kjo kërkesë e përkrahur nga dy të tretat e deputetëve të Kuvendit, do të miratohet në Kuvend, por nuk jam i sigurt se menjëherë pas kësaj, Përfaqësuesi Special i Sekretarit Gjeneral do t'i hyjë ndryshimit të Kornizës kushtetuese, që të përmbushen standardet për të cilat të gjithë së bashku angazhohemi e nuk janë të pakëta, të

cilat shumë ngadal, me vështirësi apo kursesi nuk po plotësohen. Sikur të ishin plotësuar standardet, atëherë, pas tyre do të zgjidheshin shumë çështje tjera e edhe ajo e ndryshimit të Kornizës kushtetuese ,ndoshta edhe- përgatitjet serioze për nxjerrjen e Kushtetutës së Kosovës e në këtë kontekst ,në rend dite për zgjidhje do të jenë edhe shumë çështje tjera.

Thënë shkurt, ne për momentin nuk jemi për ndryshimin e Kornizës kushtetuese. Tani për tani është mjaftë funksionale dhe se për momentin është një kornizë e shkëlqyeshme juridike për funksionimin e Kuvendit dhe institucioneve tjera të përkohshme.

Gjendja e tanishme pengon funksionimin e institucioneve të Kosovës

Ramush Haradinaj pohoi se është një punë e mirë dhe një veprim më se i domosdoshëm që Parlamenti i Kosovës e ka filluar nismën për ndryshimin e Kornizës Kushtetuese, duke e ndërlidhur me kompletimin e Qeverisë. Kjo është domosdoshmëri dhe i japim mbështetjen.

Ne duhet t'ia bëjmë me dije, në këtë rast duhet ta kuptojmë vetë, por edhe të gjithëve në Parlament e edhe partnerëve nga bashkësia ndërkombëtare se bërja funksionale dhe kompletimi i Qeverisë së Kosovës nuk do të thotë edhe zgjidhje e statusit final, por do të thotë krijim i rrethanave kur Kosova do të funksionojë edhe më mirë dhe Qeveria e Kosovës do të kryejë përgjegjësitë e veta.

Që të jemi shoqëri krejtësisht stabile, që të jemi shoqëri e përgatitur për bashkëpunim rajonal, dhe sidomos që të mund të marrim obligime edhe për integritet, ne duhet të jemi të ndërtuar dhe duhet të synojmë që të kemi kushtetutën e Kosovës, që të mundësojë funksionimin e institucioneve të Kosovës.

Gjendja e tanishme është duke penguar zhvillimin e gjithanshëm të Kosovës, funksionimin e suksesshëm të institucioneve të Kosovës dhe kësaj po e pengon

edhe përballjen tonë me vetëveten dhe me përgjegjësitë që i kemi.

Mahir Jaghillar theksoi se sipas pikës 14, neni 3 të Kornizës Kushtetuese ka mundësi që të bëhen ndryshime, ndaj ne përkrahim plotësimet në Kornizën Kushtetuese. Në vijim ai përkrahu propozimin që komisioni të ketë 7 anëtarë, duke propozuar që në këtë komision të jetë edhe një anëtar nga radhët e minoritetit turk.

Hatixhe Hoxha u pajtua me propozimin që grupi i punës të ketë 7 anëtarë, duke propozuar që anëtar i ri të jetë edhe Hydajet Hyseni.

Hasan Meta theksoi se ky komision, që duhet të bëjë meremetimin brenda Kornizës Kushtetuese, i cili lehtë mund të mos përfillet nga UNMIK-u dhe Këshilli i Sigurimit, mos është edhe një vetëmashtrim që është marifet i politikës kosovare, apo krijim i një mjegulle të re për të fituar në kohë, duke krijuar bindjen në opinion se jemi duke punuar mirë dhe të dalim në zgjedhjet e ardhshme sërish me Kornizën Kushtetuese.

Nga gjithë kjo që paraqitet këtu, është fakt se askush ende nuk e ka të qartë ku dhe si të ndërhyhet në Kornizën Kushtetuese. Rezultati mund të dalë shumë i varfër dhe prap të mbetemi me lak në fyt dhe të kufizuar: Korniza Kushtetuese dhe Rezoluta 1244.

Qytetarët e Kosovës, me të drejtë presin diçka krejtësisht tjetër nga të zgjedhurit në Kuvendin e Kosovës, duke u bazuar në premtimet e dhëna gjatë fushatave zgjedhore. Presin zgjidhjen e statusit të Kosovës në bazë të së drejtës së tyre për vetëvendosje. Kuvendi përkrahu propozimet që në vend të 5 anëtarëve të Grupit punues të jenë 8, dy anëtarët që u propozuan, kurse njëri do të propozohet nga grupi i katërt parlamentar. Në vijim Kuvendi me shumicë votash dha lejen për amendamentimin e Kornizës Kushtetuese. Kundër këtij vendimi ishin 17 deputetë.

Është shënuar progres pas takimit të Vjenës

Kosova, tha Ollbrajt, duhet të jetë shembull për të gjithë popujt, se si një vend që ka përjetuar diktaturën ka gatishmëri për një model të jetesës në paqe

Kryetari i Kuvendit të Kosovës gjatë vizitës në SHBA, ku qëndroi me ftesë të Departamentit të Shtetit, u takua me personalitete të njohura të administratës dhe politikës amerikane. Në takimin që pati me ish-senatorin Bob Dole, kryeparlamentari Daci pasi i përcolli atij përshëndetejet e presidentit Rugova e informoi për gjendjen aktuale në Kosovë, duke i vënë në spikamë edhe të arriturat e deritashme të institucioneve të Kosovës. Profesor Daci pohoi se qëllimi i institucioneve të Kosovës është inkuadrimi i minoriteteve në shoqërinë kosovare. Mirëpo, një inkuadrinim i këtillë nuk po mund të arrihet, ashtu si synohet, posaçërisht kur është fjala për minoritetin serb, edhe nga fakti që nuk kemi një zhvillim përkatës ekonomik. UNMIK-u premtonte se bartja e kompetencave të garantuara me Rezolutën 1244 do të bëhet në vitin 2003, që do të thotë se në këtë proces jemi vonuar.

Ish-senatori Dole me këtë rast theksoi se duhet të binden të gjithë me pengesat që po bënë UN, ndaj duhet bërë presion nëpërmjet Kongresit Amerikan që të ketë rezultate në proceset e gjithëmbarshme në Kosovë. Në vijim, ai tha se çuditërisht nuk ka informata të tilla në Uashington, ndaj nëpërmjet miqve tuaj duhet të njoftoni Departamentin e Shtetit për këtë, sepse faktet tregojnë se pas katër viteve nuk ka rezultate të dukshme në Kosovë. Në takimin me ish-sekretaren e shtetit Medlin Ollbrajt, kryetari Daci tha se Kosova është vendi i parë i dalë nga lufta që ka

miratuar Rezolutën për kthimin e minoriteteve, mirëpo kthimi nuk është në kompetencë të kosovarëve.

-Statuskuoja nuk është e mirë, ndaj duhet të ndryshohet diçka, por ju duhet të përqendroheni dhe të punoni në punë specifike, theksoi gjatë takimit me kryeparlamentarin Daci, z. Ollbrajt. Ajo shprehu keqardhje që nuk ka përfunduar procesi deri në fund. Kosova, tha Ollbrajt, duhet të jetë shembull për të gjithë popujt se si një vend që ka përjetuar diktaturën ka gatishmërinë për një model të jetesës në paqe. Në takimin me z. Lisa Tepper, asistente ndihmëse e sekretarit të shtetit, kryeparlamentari Daci theksoi se Qeveria ka marrë vendim për formimin e grupit për dialog me Beogradin dhe se është shënuar progres që nga takimi Vjenës. Z. Teper theksoi nevojën e unitetit ndërmjet liderëve kosovarë, të cilët nuk kanë shkuar së bashku në Vjenë.

Gjatë takimeve me theks të veçantë u fol për përmbushjen e standardeve, për çështjen e statusit të Kosovës, si dhe për faktin që UNMIK-u nuk po jep kontributin e duhur për zhvillimin ekonomik të Kosovës. Shpejtimi i zgjidhjes së statusit të Kosovës u theksua edhe në takimin me Janosh Bugajskin, nga Qendra për Studime Strategjike Internacionale. Bugajski theksoi se statusi nuk është i definuar as për Serbinë e Malin e Zi. Kosova, tha Bugajski, duhet të ngrejë zërin e vet në të gjitha instancat në Uashington për çështjet që shqetësojnë atë.

Kosova si një storie e sukseshme nëp zgjidhjen e krizave të ngjashme



Takimi Daci - Kassof

Me Serbinë mund të bisedohet për të gjitha çështjet në çdo kohë dhe vend, vetëm për statusin e politik të Kosovës jo. Bashkësia ndërkombëtare, posaçërisht SHBA-ja dhe BE-ja duhet të shfrytëzojnë rastin e Kosovës si një storie të sukseshme, e cila do t'iu ndihmonte në zgjidhjen e krizave të ngjashme, si dhe në politikën globale ndërkombëtare. Ky ishte thelbi i fjalës së kryetarit të Kuvendit të Kosovës, Nexhat Daci, në një takim me drejtorin e PER-it (Projekti për Marrëdhënie Ndëretnike) z. Allen Kassof, i cili u mbajt në Kuvendin e Kosovës, me ç' rast u bisedua për ardhmërinë e Kosovës dhe të rajonit, si dhe për procesin e dialogut Prishtinë - Beograd, dhe me vendet tjera të rajonit.

“Do të mundohemi të nxjerrim elementet e kësaj eksperience pozitive, do të shohim se çfarë do të mund të mësojmë nga këto eksperiencat pozitive për t' i përcjellë ato tek të tjerët”, theksoi Allen Kassof në prononcimin pas takimit. Në vijim z. Kassof theksoi se statusi i ardhshëm i Kosovës do të varet plotësisht, në shkallë të konsiderueshme nga suksesi që do të ketë Qeveria dhe projektet politike për krijimin e një mjedisi të përshtatshëm, ku të gjitha grupet e ndryshme do të jetojnë së bashku. Nuk kam dyshim se do të bëhet progres, në disa prej standardeve, duke përfshirë atë mbi çështjen e të kthyerve dhe sigurinë, theksoi z. Allen Kassof.

Z. Kassof është duke përgatitur edhe një konferencë, e cila do të mbahet në Zvicër, në të cilën do të marrin pjesë liderët e të gjitha shteteve të rajonit.

Shqyrtohet projektligji kundër diskriminimit

Personat që e konsiderojnë veten të diskriminuar, kanë në dispozicion mbrojtjen adekuate ligjore dhe do të mund t'i drejtohen organit i cili do të themelohet enkas për këto çështje. Ky organ do të ofrojë dhe analizojë posaçërisht problemet që do të hasen, do t'i studiojë zgjidhjet e mundshme dhe do të ofrojë ndihmë juridike konkrete për personat e diskriminuar

Në mbledhjen e 30 tetorit të Kuvendit të Kosovës u bë shqyrtimi i parë i Projektligjit kundër diskriminimit. Fjalën hyrëse për këtë projektligj e paraqiti kryeministri i Kosovës Bajram Rexhepi. Ai tha se në pajtim me mbrojtjen e parimit të lirisë dhe demokracisë, respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe faktin se parimi i mosdiskriminimit paraqet doktrinën themelore të legjislacionit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut, që janë edhe pjesë e ligjit në Kosovë, Qeveria e Kosovës ka marrë iniciativën për përgatitjen e Projektligjit kundër diskriminimit.

Një hap drejt mundësive të anëtarësimit në Bashkësinë Evropiane

Ky Projektligj është përgatitur për një kohë relativisht të gjatë, ndërsa puna rreth hartimit është koordinuar me ekspertë vendës dhe ndërkombëtarë, si dhe me përfaqësues të UNMIK-ut. Ligji synon pengimin e çfarëdo forme të diskriminimit për të gjithë kosovarët. Ky ligj është në pajtim me ligjet dhe standardet ekzistuese antidiskriminuese në nivelin evropian dhe ndërkombëtar dhe përmbushje e obligimeve të Kornizës Kushtetuese për institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes në Kosovë, sepse përmbush në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe thellësisht këto obligime.

Dëshiroj të theksoj se ligji është i bazuar drejtpërdrejt në direktivën e Këshillit të Unionit Evropian 2000/43 lidhur me implementimin e parimit të trajtimit të barabartë të personave, pa dallim përkatësie racore e etnike. Mirëpo, duke mos qenë i kufizuar vetëm në diskriminimin mbi baza racore e etnike, i njëjti është zgjeruar edhe në mbrojtjen e kategorive tjera, si: gjinisë,

moshës, gjuhës, mendimit apo bindjes politike, përkatësisë kombëtare, përkatësisht fetare, personave me aftësi të kufizuara e tjerë dhe i është përshtatur rrethanave dhe specifikave të Kosovës.

Ligji kundër diskriminimit do t'i mbrojë pa dallim të gjithë personat fizik dhe juridik të sektorit publik dhe privat, në fushën e punësimit, pagesës, largimit nga puna, anëtarësimin dhe përfshirjen në organizata të punëtorëve, mbrojtjen sociale, arsimimin, trajtimin e barabartë para organeve të drejtësisë dhe çdo të drejtë tjetër të paraparë me aktet në fuqi.

Zbatimi i këtij ligji, në mënyrë efikase ndikon në trajtimin e barabartë të qytetarëve në të gjithë lëmenjtë e jetës, e në veçanti trajtimin e barabartë në kuadër të institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes.

Personat që e konsiderojnë veten të diskriminuar, kanë në dispozicion mbrojtjen adekuate ligjore dhe do të mund t'i drejtohen organit i cili do të themelohet enkas për këto çështje. Ky organ do të ofrojë dhe analizojë posaçërisht problemet që do të hasen, do t'i studiojë zgjidhjet e mundshme dhe do të ofrojë ndihmë juridike konkrete për personat e diskriminuar.

Karakteristikat e veçanta të këtij ligji mund të përmbledhen si vijon:

- përkufizimet e kuptimeve të diskriminimit të drejtpërdrejtë dhe diskriminimit të tërthortë, ngacmimit, viktimizimit dhe segregacionit;
- fushëveprimin e ligjit përkatësisht fushave ku ndalohet diskriminimi bashkë me masat afirmative;
- rregullat lidhur me barrën e të provuarit në të cilat raste barra e të

provuarit duhet të kalojë te pala e paditur me rastin e paraqitjeve së dëshmime kundër diskriminimit, me përjashtim të procedurave gjyqësore penale;

- Sanksionet e parapara, dënimet me gjobë dhe formimi i qendrës për trajtim të barabartë.

Konsideroj se ligji bart edhe përparësinë e vet politike se si ta vendosë Kosovën në ballë të legjislacionit kundër diskriminimit, në Ballkan dhe Evropë dhe ky është një tregues i drejtpërdrejtë, se me nxjerrjen e ligjit kundër diskriminimit Kosova, që në hapat e parë të përpilimit të legjislacionit vendor, po bën harmonizimin e plotë të akteve të veta juridike me legjislacionin evropian.

Njëkohësisht kjo do të mund të konsiderohej si një hap drejt mundësive të anëtarësimit në Bashkësinë Evropiane, sepse nxjerrja e këtij ligji drejtpërdrejt përputh legjislacionin vendës me atë evropian.

Ligji gjithashtu paraqet digë të fortë për garantimin e lirive dhe të drejtave të kosovarëve dhe fuqizimin e sundimit të së drejtës, theksoi Bajram Rexhepi.

Ligji përfshin realizimin e trajtimit të barabartë të të gjithë personave në Kosovë

Zylfije Hundozi theksoi se populli ynë ka qenë gjithmonë kundër diskriminimit, prandaj është mirë që këto synime janë formuluar në formë të ligjit, i cili sot po shqyrtohet në këtë Parlament.



/ vijon në faqe 8 /

Ligji përfshin realizimin e trajtimit të barabartë të të gjithë personave në Kosovë, duke mos lejuar diskriminimin e drejtpërdrejt ose të tërthortë në asnjë aspekt. Në Projektligj, kuptohet është bërë përpjekja e gjithpërfshirjes së problematikës në fjalë dhe tendenca që ky Projektligj të jetë sa më i qartë. Duke bërë disa vërejtje në këtë projektligj Hundozi u shpreh se ekziston një humbje e lidhshmërisë së qëllimit që ka ky Projektligj dhe parimeve që i parashtron, siç është parimi i drejtë i përfshirjes së punësimit, vetëm në organet publike e qëllimi është që të mundësohet punësimi pa diskriminim në të gjitha fushat e punësimit të mundshëm.

Në dispozita të veçanta, nuk ceket afati se gjer kur do të formohet qendra për trajtim të barabartë, si dhe raporti i saj ndaj Ombduspersonit, por në tekst, edhe pse ceken autorizimet e qendrës, mbetet të kuptohet se kemi të bëjmë vetëm me një hipotezë.

Alush Gashi tha se është nder dhe kënaqësi e posaçme për mua që, në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, ta mbështes këtë Projektligj kaq të rëndësishëm për fatin e zhvillimit dhe ardhmërisë së vendit tonë. Në një Kosovë të pavarur dhe demokratike, ligji i zgjedhur dhe i hartuar mirë i diskriminimit është esencial.

Duke pasur shumë pyetje, sa i përket qendrës për diskriminim, e për të cilën besoj se do të ketë mundësi të bisedohet në punë të mëtutjeshme, në emër të Grupit, mbështesim këtë ligj dhe do të japim kontributin tonë në fazat e mëtutjeshme.

Parimin e mosdiskriminimit e kemi në të gjitha ligjet e Kosovës

Arsim Bajrami pohoi se ky ligj është i domosdoshëm për Kosovën,

duke qenë se Kosova është në ndërtim të shtetësisë së vet dhe në ndërtim të një identiteti evropian. Në këtë rrugë ne duhet patjetër sa më shpejt të pretendojmë standardet evropiane, theksoi Bajrami.

Mirëpo, dëshiroj të theksoj se Kosova, qysh në fazën e tanishme ka bërë mjaft sa i përket garantimit të parimit të mosdiskriminimit dhe mendoj se Korniza Kushtetuese është një akt kushtetues që ka shkuar përtej standardeve ndërkombëtare, sa i përket trajtimit të barabartë të të gjithë qytetarëve të saj, por aq më tepër, ka bërë edhe një diskriminim pozitiv, një diskriminim pozitiv të minoriteteve, si një dëshmi e Kosovës për të pranuar standardet ndërkombëtare dhe për të ndërtuar një shoqëri civile, një shoqëri qytetare, ku të gjithë do të jenë të barabartë.

Mendoj se ky diskriminim pozitiv ka qenë edhe një dëshmi që Kosova është e gatshme për të integruar minoritetet si pjesë të barabarta të saj dhe si pjesë e cila vetëm sa pasuron pasqyrën e Kosovës.

Ky ligj, i cili po përgatitet, në fakt është një ligj bazik, meqenëse parimin e mosdiskriminimit e kemi në të gjitha ligjet e Kosovës. Në qoftë se keni parë, të gjitha ligjet që i kemi miratuar, bazohen në parimin e mosdiskriminimit në baza të ndryshme. Por, është mirë që ta kemi një ligj bazik, i cili në fakt i përmban parimet e përgjithshme të mosdiskriminimit, që pastaj në ligjet të tjera të përpunohen.

Unë mendoj se krahas këtij ligji, që sot po e diskutojmë, ne duhet të mendojmë në një të ardhme jo fort larg, për të përgatitur edhe ligjin për të drejtat e minoriteteve, ashtu siç kanë bërë edhe shtetet tjera në tranzicion, në mënyrë që vërtetë t'i arrijmë këto standarde më të larta që parashihen edhe me konventa ndërkombëtare dhe të japim garancione që jemi të gatshëm për të



mbrojtur të gjithë qytetarët e Kosovës.

Megjithë faktin që është punuar një ligj relativisht i mirë, unë mendoj se ai ka mjaft të meta, të cilat, në leximin e dytë, duhet të përmirësohen me amendamente, do të thoja pak më substanciale. Unë po përmendi disa të meta.

E para, thashë kompozicioni jologjik i ligjit. Ka shumë pjesë teknike dhe pjesë përmbajtësore. Është një përzierje. Është përshtypja se është marrë nga disa modele diçka dhe është bërë një kombinim artificial i këtij ligji.

Pastaj, nëntitujt janë plotësisht joadekuat. Në ligj ka edhe dispozita që janë qëndrime politike dhe që nuk mund të jenë norma juridike. Po e zëmë, mungon gjuha ligjore e ligjit, te formulimi në nenin 2, pika c) ku thuhet një objektiv i ligjit: "Parimi i sigurimit të bashkëjetesës dhe përkrahjes së pajtimit të popullit të Kosovës". Kjo çështje nuk është çështje e normës juridike. Kjo është një proces politik. Nuk mundemi në normë juridike ta bëjmë - pajtimi. Pajtimi duhet të jetë një realitet faktik. S'mundemi me normë juridike të obligojmë qytetarët që të pajtohen, por ky është një proces i cili duhet të ndërtohet. Kështu që, kjo është një dispozitë atipike e cila duhet të shqyrtohet.

E njëjta gjë është edhe në nenin 10, ku përmendet dialogu shoqëror. Pra, një normë ideologjike e sistemeve të kaluara, që nuk është tipike për doktrinën moderne të normimit juridik.

Dr. Dragi Sh. Kërstoviq theksoi se këtë që dua ta them tani nuk është në natyrën time,

por i nxitur nga fjalët e profesor Gashit dhe profesor Bajramit, detyrohem ta them. Me një ligj të tillë as nuk ndërtohet shteti e as nuk fitohet pavarësia.



Nevoja për nxjerrjen e këtij ligji është e pakontestueshme dhe ky ndoshta është dashur të jetë ligji i parë i nxjerrur nga ky Kuvend ,dmth. para të gjitha ligjeve të miratuara nga ky Kuvend dhe këtë nga arsyeja e thjeshtë, për shkak se jetojmë në një ambient specifik,në një hapësirë ku pason koha e pasluftës, ku formohen institucionet e reja dhe ku multietniciteti dhe multikonfensionaliteti janë karakteristikë e kësaj hapësire.

Fatkeqësisht,Projektligji,sipas mendimit të grupit parlamentar të koalicionit "Kthimi",nuk është i mirë dhe ai është vetëm se një version i deformuar i Kartës së Kombeve të Bashkuara për ndalimin e diskriminimit.

Projektligji është i tillë sa që edhe me amendamentet më të mira nuk mund të përmirësohet.Projekti është i shushatur,formulimet plotësisht të pakuptueshme , prandaj për këtë shkak dhe paqartësive tjera është i pazbatueshëm.

Ju lutem më lejoni t'i lexoj vetëm disa rreshta në ligj i vetëdijshëm se, në mesin e kolegëve shqiptarë ka mjaftë që në mënyrë të shkëlqyeshme e njohin gjuhën serbe, si dhe natyrën dhe shpirtin e kësaj gjuhe.

Mua nuk më është e qartë se si në nenin 2 pika a),në luftën kundër diskriminimit, përparësi i ipet gjinisë,moshës së shtyerë, gjendjes bashkëshortore etj.aq më tepër edhe prirjeve seksuale, kështu që pas gjithë kësaj, radhitet mbrojtja e përkatësisë kombëtare ,kurse ajo etnike -fare nuk figuron.

Nëse një formulim i tillë mund të shkojë në procedurë, atëherë me të vërtetë nuk e di se çka duhet të bëjmë ne këtu.Ta zëmë në gojë nenin 3 pika a). Unë ju kisha lutur për vëmendje " diskriminim i drejtpërdrejt është kur ndaj një personi është vepruar, veprohet dhe do të veprohet njësoj në krahasim me të tjerët,duke u bazuar në një apo më shumë themele të përshkruara nën 2 pika a)".

Nëse këtë dikush mund ta interpretojë dhe nëse ekziston një jurist i tillë që ta interpretojë këtë, unë sinqerisht atyre njerëzve do t'ua shtri-

ja dorën.

"Viktimizimi" është shprehje që unë askund s'kam mundur ta gjej, as në enciklopeditë juridike e as në të tjerat.Thënë shkurt, një shprehje e tillë, hë për hë, në gjuhën serbe nuk ekziston.

Faik Marolli, theksoi se Grupi i të tjerëve, i quajtur etnik, përkrah në parim këtë Projektligj. Ky Projektligj ka hapësirën e vet dhe më vonë do të korrigjohet dhe do të plotësohet me amendamentet e veta.



Sabri Hamiti theksoi se më pëlqen titulli : ligj kundër diskriminimit dhe përfundimisht, për fillim dhe për fund, le të dihet gjithmonë që nëse nxirret një ligj i tillë, atëherë nuk do të pranohen, as në mënyrë ligjore, as në të folur, tipet e diskriminimit pozitiv ose negativ. Dhe të pushojnë përgjithmonë tipet e tilla të diskriminimeve. Edhe brenda këtij ligji, po unë besoj se do të saktësohet, ekzistojnë rregulla jo të deklaruara me këtë formulim qysh po e them unë, por në të vërtetë në mënyrë tinzare dalin elemente që quhen, me gjuhë tjetër – diskriminim pozitiv.



Unë mendoj se kjo duhet të fshihet përgjithmonë nga diskursi, edhe i të folurit që po bëhet politik zakonisht, edhe në formulimet gjuhësore, ashtu si edhe në alinetë e ligjeve. E dyta, përnga natyra, ligji, u tha këtu, me të vërtetë forma e tij më shumë i ngjet një konvente për trajtim të barabartë dhe sigurisht se do të ketë punë në ndërtimin e tij.

Hydajet Hyseni theksoi se pikërisht sot, kur ne po shqyrtojmë

Projektligjin kundër diskriminimit të qytetarëve të Kosovës, në të vërtetë ne jemi ballafaquar me një diskriminim pikërisht të popullit të Kosovës, taman ashtu si thuhet në nenin e parë. Sot në Këshillin e Sigurimit debatohet për Kosovën, pa Kosovën. Debatohet madje për dialogun Prishtinë – Beograd, pa përfaqësuesit e Kosovës e duke pasur aty ata që s'e kanë vendin fare. Unë pajtohem me ata që tërhiqnin vërejtjen që diskriminimi pozitiv, i ashtuquajtur diskriminim pozitiv i dikujt të mos shkaktojë edhe diskriminim negativ të të tjerëve, shpesh edhe të popullatës shumicë, ose të komuniteteve tjera pakicë. E kjo, ndonjëherë ndodh.



Unë do të dëshiroja të theksoj madje edhe faktin se nuk e konsideroj favorizim në favor të realizimit të të drejtave të qytetarëve të Kosovës, edhe të komuniteteve, nëse ajo nënkupton privilegje absurde. Nuk do të ishte antidiskriminim nëse do të lejoheshin që dikush, si pjesëtar i një kombësie të caktuar, të mos paguajë tatimet, të mos paguajë telefonin, të mos paguajë rrymën, të mos bartë targarat dhe të mos respektojë ligjet. Mendoj që kjo, në të vërtetë, pikërisht dëmton atë që synohet, do të thotë: krijimin e raporteve normale me një kujdes të veçantë ndaj komuniteteve pakicë.

Fatmir Sejdiu theksoi se prezenca e drejtpërdrejt e kryeministrit është një porosi e përbashkët për mënyrën e përgatitjes së projekteve që vijnë në Parlament dhe koherencën e tyre. Çështja e parë, ajo që u shtrua edhe në pjesën e debatit,



është çështja e mosharmonizimit të bollshëm të teksteve, që është çështje parimore në gjuhën shqipe, në angleze apo në gjuhën serbe, të cilat janë të ofruara para nesh.

Çështja e dytë, ajo që dëshiroj të tërheq vërejtjen, është çështja e krijimit të dualizmit të pushteteve në projektet ligjore. Një nga normat që është ofruar në këtë ligj, në këtë Projekt, ta zëmë, nenin 7. Merreni dhe shikojeni – praktikisht është një dilemë e madhe se kush duhet të veprojë sipas kësaj preference. Duhet të jetë ajo zyrë që tash do të pretendohet të ndërtohet, apo duhet të jenë gjykatat dhe të na dalë nesër një konflikt i drejtpërdrejt i njëjës dhe i tjetrës, atëherë nga të shkojë pala?

Do të thotë duhet të jetë një kërkesë serioze në harmonizimin e asaj se çka është pjesë e një veprimtarie në një projekt që hyn në fushën e ekzekutivit dhe çka është pjesë e preferencës me ligj dhe që kalon në pushtetin gjyqësor apo në fusha të tjera.

Ne patëm rastin edhe në ligjin për trajtimin e barabartë të gjinive, në fazën e kaluar, ndërtimi i një zyre, tash ndërtimi i një zyre etj. Të kemi një kujdes sa do të jetë e domosdoshme dhe sa është një pjesë që mund të bartet në funksione në organizma tjerë.

Hajredin Kuqi theksoi se pajtohet me dëshirën që të tregojmë se jemi të gatshëm për jodiskriminim, por njëkohësisht shprehu mendimin se nuk kemi nevojë të tregojmë diçka më shumë se sa ato që janë me konventa ndërkombëtare.



Liljana Keniq tha se sigurisht ju është në kujtesë Raporti i dhjetë i OSBE-së për poziten e bashkësive etnike. Qëllimisht i iki shprehjes pakica, në të cilën në rezime, në njëjërë

anë, konstatohet se disa bashkësi, para së gjithash ajo serbe, në shkallë të ndryshme, janë të ballafaquara me maltretime, frikësime dhe provokime, si dhe me kufizimin e lirisë së lëvizjes. Në anën tjetër, janë dhënë rekomandime që të miratohet omnibus ligji kundër diskriminimit, si hap i domosdoshëm kundër diskriminimit, i cili në mënyrë të drejtpërdrejt apo tërthorazi, me qëllim apo pa të, paraqet pengesë të rëndësishme që të gjitha bashkësitë e sidomos ajo serbe të jetojnë jetë të arsyeshme.

Edhe unë do ta përkrahja këtë ligj nëse do të ndihmojë në ndalimin e vrasjes së serbëve, vetëm pse janë serb; nëse ligji do të ndihmojë në ndërprerjen e sulmeve me bomba në Černicë, në mënyrë që Miomir Saviçi të jetë viktimë e fundit e dhunës mbi serbët; nëse do të ndihmojë që fëmijët serb të mos vriten më; nëse ligji do të ndikojë që drejta për lëvizje të lirë të mos jetë vetëm si mision... për bashkësinë serbe; nëse do të ndihmojë që, pa marrë parasysh cili serb i kthyer si Sofijana Periçi nga Gjilani, të përfundojë në spital. Si të zbatohet ligji në praktikë? Personalisht, nuk jam e bindur se kjo do të ndodhë.

Ramadan Kelmendi tha se Ligji duhet të parashohë edhe masat ndëshkimore për padinë e rreme lidhur me diskriminimin e paarsyeshëm, ngase në këtë situatë do të krijohet një anarki e madhe kur kihet parasysh situata në Kosovë, që është krijuar me vite të tëra në raporte ndëretnike, si dhe kompensimi për dëmin moral apo qoftë material lidhur me diskriminimin.



Për mua është i paqart, i paarsyeshëm dhe i pashpjegueshëm dhe jo i drejtë formulimi i dispozitës së nenit 10 – dialogu shoqëror; nenit 11 – dialogu me organizatat joqeveritare, e tjera.

Ankesat, lidhur me diskriminimin, do t'i shqyrtojë avokati i popullit të Kosovës, por duhet të dimë se veprimi ligjor i tij nuk është përcaktuar dhe se vendimet e tij nuk mund të ekzekutohen në këtë fazë. Sido që të jetë, nuk është përcaktuar forma e ekzekutimit të vendimit të avokatit të popullit të Kosovës. Kjo e pengon realizimin e këtij ligji.

Rangjel Nojkiqi theksoi se me të vërtetë Grupi parlamentar serb ka shumë arsye të mos votojë për këtë ligj. Unë me të vërtetë desha, në mënyrë konstruktive, të diskutoj për ligjin, para së gjithash kur bazohem në dokumentet nga Universiteti i Finlandës të cilat sigurisht i keni edhe ju, të lexoni çka është diskriminimi, çka janë të drejtat e njeriut, çka janë të drejtat dhe liritë e të gjithë njerëzve në këto hapësira, para së gjithash receta që e ka dhënë Unioni evropian për shkak se dëshirojmë të rreshtohemi në Unionin evropian a sillemi në atë mënyrë që nuk përkon me Unionin evropian.

Xhavit Haliti shprehu bindjen se asnjëri këtu nuk është i interesuar t'ia kufizojë të drejtën e të shprehurit për ligjin, por jo të na akuzoni zotëri akoma pa e thënë fjalën e vet ligji, pa e thënë fjalën e vet drejtësisia, pa e thënë fjalën e



vet ata që janë të autorizuar të ndjekin krimin. Unë jam i bindur dhe dua të kërkoj sinqerisht që të punojmë së bashku për ta ndërtuar jo vetëm legjislacionin e Kosovës, i cili do të duhej të ishte një legjislacion i pranuar nga të gjithë mekanizmat ndërkombëtar dhe nga gjithë qytetarët e Kosovës, sepse, siç e thatë edhe ju – po përpiqemi të shkojmë në Evropë, po përpiqemi të inkuadrohemi si qytetarë të Evropës e jo si njerëz të cilët akuzojmë njëri-tjetrin edhe kur të shohim ëndërra, sepse gjoja ëndërrat i ka instrumentalizuar dikush dhe ata që instrumentalizojnë ëndërra qenkan një shumicë ose një pjesë e një popullate e cila realisht ka qenë gjithmonë e shtypur, gjithmonë e keqtrajtuar, gjithmonë pa të drejta dhe tani po përpiqemi që t'i harrojmë të këqijat, ta harrojmë një të kaluar të hidhur barrën e së cilës, në qoftë se ju pranoi që keni pasur qeveri dhe instrumentet e dhunës e keni përgjegjësinë shumë - shumë më të madhe ju se sa ne, sepse ne s'kemi asnjë lloj përgjegjësie për hegjemonizmin që e kanë bërë qeveritë tuaja të njëpasnjëshme mbi këtë popullatë të pafuqishme dhe të pambështetje deri pas fillimit të bombardimeve të NATO-s dhe deri pas vendosjes së një demokracie ta quajmë, të cilën së bashku po përpiqemi ta realizojmë.

Blerim Baruti pohoi se me këtë ligj parashihet të formohet qendra për trajtim të barabartë, ndërsa tash e një kohë funksionon edhe institucioni i Ombduspersonit të Kosovës. Me këtë rast është mirë që të përmenden edhe disa fakte në shoqërinë tonë që tregojnë nivelin e civilizimit.



Sot, në këtë Kuvend të Kosovës, nga 120 deputetë, 35 janë minoritarë. Nga këta 20 vende janë të rezervuara vetëm për ta që, shprehur në përqindje, kjo pjesëmarrje është

rreth 30%, edhe pse në Kosovë jetojnë mëse 90% të popullatës shqiptare. Në Qeverinë e Kosovës janë 3 ministra që i përkasin minoritarëve. Po ashtu, në Kuvendin e Kosovës, pjesëmarrja e gjinisë femrore është 30%. Në legjislacionin kosovar, që nga miratimi i ligjit të parë, e deri te ky ligj, ligjet e sjella janë të një niveli që gjithnjë kanë pasur parasysh përputhshmërinë me standardet, ligjet e normat evropiane e ndërkombëtare.

Ligji duhet t'i përfshijë disa pjesë edhe nga Konventa Ndërkombëtare kundër diskriminimit

Oliver Ivanoviq theksoi se sa i përket ligjit të cilin edhe e kam shikuar, mund të them se si i tillë në parim sigurisht se e ka vendin e vet. Këtë, përfaqësohet e kanë përkrahur edhe deputetet tjerë të koalicionit serb që diskutuan deri më tani. Dua të them mos na diskualifikoni menjëherë vetëm për shkak të vërejtjeve që i japim.




Ne këtu kemi biseduar edhe për disa ligje që janë shqyrtuar në mbledhjet e mëparshme. Ato ligje janë të mangëta, sepse thënë thjeshtë nuk janë të zbatueshme.

Ne duhet të jemi njerëz me përgjegjësi. Për mua kjo do të thotë shumë kur sot Kryeministri në ekspozitën e tij e propozoi edhe këtë ligj. Kjo do të thotë se është prioritet i tij, si njeriu i parë i Qeverisë, që me çdo kusht ta eliminojë diskriminimin ose ta sanksionojë me ligj. Propozoj që vet Kryeministri këtë ligj ta tërheq nga procedura. Ky ligj meriton ndryshime serioze, pengesa serioze. Ligji si i tillë është i nevojshëm, por në përmbajtje, sipas parimit se si është përpiluar, pjesët e të njejtë janë në kundërshtim me pjesët tjera

të këtij ligji dhe se kjo nuk është mirë edhe për ta kuptuar por edhe për zbatimin e tij.

Nekibe Kelmendi tha se ky ligj në parim duhet të përkrahet, sepse ne jemi ngopur me diskriminime. Diskriminime pozitive kurrë nuk kemi përjetuar, por vetëm diskriminime negative dhe atë institucionale e faktike. Prandaj mendoj se ky ligj duhet të përpunohet edhe pak, duhet t'i përfshijë disa pjesë, ndoshta edhe direkt të Konventës Ndërkombëtare kundër diskriminimit dhe në procedurë të mëtejme të shqyrtohen dhe të miratohen.



Milovan Jovanoviq tha se asnjë ligj dhe kurrfarë ligjesh nuk do të ndihmojnë nëse shqiptarët në mënyrë kolektive dhe individuale nuk e kuptojnë se serbët si popull, nuk flas për ndonjë rehim dhe politikaj etj., nuk janë fajtorë për tërë atë që ka ndodhur, por populli kurrë nuk mund të jetë fajtorë. Fajtorë janë individët dhe sistemet politike si dhe orientimet e atyre sistemeve etj.



Orientimi është që qëllimisht përmes një ligji të improvizuar të rregullohet çështja e diskriminimit dhe pastaj konsiderohet se kjo çështje është zgjidhur, më nuk ka diskriminim dhe se çdo gjë është në rregull.

Edhe pse është tërësisht e qartë se dispozitat e këtij ligji nuk mund të zbatohen në praktikë, ne thjeshtë nuk mund të biem në atë situatë që individualisht të diskriminohemi, për shkak se ne nuk e kemi lirinë e lëvizjes së lirë. Në vijim sipas propozimit të kryetarit të Kuvendit të Kosovës u votua dhe në parim u përkrah Projektligji.

Kriza e një pjese të sistemit të drejtësisë dhe të gjyqësorit në Kosovë

Nga mr.sci. Ramadan B. KELMENDI

Eshtë e ditur se shteti pa sistem të mirëfilltë juridik dhe gjyqësi të vërtetë krijon padrejtësi më të mëdha, nuk siguron lirinë individuale dhe as atë kolektive, shkelet kushtetueshmëria e ligjëshmëria.

Pikërisht në Kosovë, një pjesë e sistemit të drejtësisë dhe të gjyqësisë është në krizë të madhe, në veçanti kjo krizë buron nga mungesa e Ministrisë së Drejtësisë dhe aplikimi i një sistemi juridik që zbaton ligjet e ish-pushtuesit, (ligjet e Serbisë), duke krijuar paradoks juridik të tipit të veçantë në botë, të një sistemi juridiko-gjyqësor jo demokratik me elemente të teknokracisë. E them këtë sepse një ndër themelet e shtetit është drejtësia, ndërsa ajo realizohet nëpërmjet gjyqësisë, respektivisht gjyqtarëve e prokurorëve, por në rastin konkret kur gjyqtarët dhe prokurorët nuk i emëron populli nëpërmjet përfaqësuesve të vet të zgjedhur – deputetëve, atëherë dihet se cili është qëllimi dhe niveli i asaj pjese të gjyqësisë.

Emërimet pa kritere

Ajo që e ka bërë shtetin ferr mbi tokë është padrejtësia dhe gjyqësia e korrumpuar, gjyqësia jo profesionale, gjyqësia e dalë jashtë interesave të popullit etj., sepse aty ku nuk ka ligje autonome, aty ku ligjin e zbaton ai që nuk e meriton, nuk ka liri. Kosova, nëpërmjet Qeverisë dhe Kuvendit të saj po bën punë të konsiderueshme për ndërtimin e një sistemi juridik, i cili do të mbështetej në parimet e sundimit të së drejtës dhe të një sistemi gjyqësor me kuadër profesional, jurist të dalluar, të paanshëm e të pavarur, pa të kaluar të dyshimtë, me karakter dhe dinjitet të

lartë njerëzor dhe të përkushtuar në drejtësi e jo në politikën ditore dhe përkrahje të pushtetmbajtësve.

Fatëkeqësisht, KGJPK propozon dhe emëron gjyqtarë të të gjitha niveleve pa procedurë paraprake, pa kritere, një pjesë e të cilëve kanë dhënë betimin në Beograd, kanë zbatuar dhe ende zbatojnë ligje me diskriminuese në botë, ligjet e Serbisë, ata as nuk kanë dhënë betimin në Kuvendin e Kosovës. Këtë seleksionim negativ e bën KGJPK, ndërsa formalisht, megjithëse jepen vërejtje dhe nuk miratohen në Kuvend, ata fillojnë punën duke krijuar një sistem gjyqësor të brishtë në Kosovë.

Në botën demokratike me sistem juridik të përparuar, me gjyqësi të pavarur, opinioni publik është tejet i ndjeshëm dhe i ashpër në rastin e implikimit në sistemin gjyqësor të individëve të korrumpuar dhe me përvoja diskriminuese, si dhe me persona të pensionuar të një sistemi të kaluar.

Në disa raste, e në veçanti në sistemin gjyqësor në Kosovë, po krijohet një ndryshim i madh në mes asaj që është shkruar në dispozitat ligjore dhe zbatimit të tyre në praktikë.

Konkretisht, në tri propozimet e fundit për gjyqësorin në Kosovë, KGJPK vazhdimisht ka cenuar Kodin e etikës dhe të sjelljes profesionale të gjykatësve dhe seksionin 9, 4, 7 të Kormizës Kushtetuese të Kosovës, duke bërë seleksionim negativ, duke sjellë regjistra me emra para deputetëve, vetëm për të plotësuar anën formale se kanë punuar deri në mars 1999, që kanë dalë në pension, kanë zbatuar ligjet diskriminuese serbe, që kanë pasur simpati ndaj rrënimin të subjektivitetit të Kosovës, që kanë dënuar grevistët e protestuesit, ata që kanë bartur flamurin kombëtar, që kanë

ngritur dy gishtërinj , që kanë pasur veshje kuq e zi, ata që kanë miratuar Deklaratën Kushtetuese për Pavarësinë e Kosovës, më 2 korrik 1990, Kushtetutën e Republikës së Kosovës, ata që kanë ndihmuar popullin nëpërmjet shoqatës “Nëna Tereze”, ata që janë bashkuar në BSPK, ata që e kanë kundërshtuar politikën e Serbisë, ata që serbëve ua kanë thënë të vërtetën, e që Serbia i quante nacionalistë, seperatistë, irredentistë etj., ata që rrokën armët e u bënë anëtarë të UÇK-ës etj. Fjala është për ata gjyqtarë që pranuan masat e dhunshme të pushtetit të Serbisë, që zbatuan vendimet e Kuvendit të Serbisë, pranuan gjuhën serbe dhe alfabetin qirilicë në punën e përditshme sipas diktatit të Serbisë.

Këta gjyqtarë të mjerë që u fortifikuan në vendet e punës si gjyqtarë të sistemit juridik të Milosheviqit direkt apo indirekt morën pjesë në ndërtimin e politikës diktatoriale, që ishte në kundërshtim me përmbajtjen e Kodit të etikës së gjyqtarit.

Kjo dukuri sa është e rrezikshme aq është edhe e tmerrshme për shoqërinë kosovare, sepse fjala është për njerëzit që do të punojnë në tempullin e drejtësisë aty ku ndahet, mbrohet, dhe realizohet e drejta.

Nuk jepen shënime për shërbimin korrektues

Sot, në Kosovë drejtësia zbatohet nga një numër gjyqtarësh (fatmirësisht jo të gjithë) të pazgjedhur, të cilët as që e kanë dhënë betimin para Kuvendit të Kosovës, e disa edhe zbatonin politikën poshtëruese të Serbisë. Të gjitha këto faktikisht bënë që në Kosovë të kemi një sistem gjyqësor joefikas, të padrejtë, joprofesional, jo të pavarur e shumë të njëanshëm. >>>>

<<<<

Me gjyqtarë të tillë në vend se të ndërprehet juridiksioni i Serbisë në Kosovë, atij në fakt i zgjatet jeta. Sistemi gjyqësor i Kosovës është ngusht i lidhur edhe me shërbimin korrektues për të cilin në opinion nuk jepen shënime të duhura mbi mënyren e funksionimit, numrin dhe strukturën e të punësuarve, kushtet e punës të të punësuarve, tipet e burgjeve, sistemin edukues-korrektues, numrin e të dënuarve, kushtet e jetës në burgje etj.

Dihet fare mirë se Burgu i Mitrovicës është pa asnjë oficer korrektues shqiptar dhe pa asnjë të punësuar shqiptar në administratë, ndërsa sistemi juridik i Kosovës veriore (Mitrovica – Zveçani, Leposaviqi, Zubin Potoku) ende nuk është integruar në sistemin kosovar të gjyqësisë, sikur që ende nuk dihet fati i 8.620 denoncimeve të bëra nga qytetarët e Mitrovicës pranë Xhandarmërisë Frënge në muajt shtator, tetor, nëntor, dhjetor 1999 kundër forcave ushtarako-policore-militare serbe, të cilat kanë ushtruar: terror, djegie, vjedhje, vrasje, maltretime, dëbime të shqiptarëve. Vallë kjo është drejtësi? Të gjitha këto po lënë pasoja të rënda për të drejtat pronësore-juridike dhe të drejtat tjera të qytetarëve.

Shtrohet pyetja : a mundet Gjyqësia Kosovare me disa gjyqtarë të paemëruar, joserioz, pa autoritet në rrethin e vet, joprofesionistë, të korruptuar, ngusht të lidhur po ashtu me disa avokatë profiterë, ta zbatojnë drejtësinë.

Ose a ka të drejtë qytetari kosovar, i cili tërë jetën e sakrifikoi e luftoi për lirinë çfarë e kemi në Kosovë, të dyshojë në vendimet e marra nga këta gjyqtarë.

Kur kuvendi i një shteti emëron gjyqtarë të padenjë për të zbatuar drejtësinë, atëhere u jep të drejtë të pa drejtëve që në emer të popullit t' i gjykojnë të drejtit, e kësaj nuk i thonë assesi ndryshe pos shtrembërim I qëllimshëm i sistemit ligjor e të drejtësisë. Këtu më nuk mund të bëhet fjalë për ligjëshmëri, por vihet në pikëpyetje i tërë sistemi gjyqësor dhe korrektues. E ne në Kosovë më së paku kemi arsye ta bëjmë këtë.

Vlerësoj se Gjyqësia e Kosovës ka nevojë të shkundet, të bëhet e pavarur dhe meritore , ashtu siç nuk kam dyshim se në mesin e gjyqtarëve ka të atillë që e meritojnë ndarjen e drejtësisë.



Gjiçani

Komunat e goditura nga tërmeti morën mjetet e ndara nga Kuvendi i Kosovës

Në mbledhjen e 6 nëntorit, deputeti Fatmir Rexhepi njoftoi deputetët se vendimi i këtij Kuvendi, që është marrë vitin e kaluar për ndihmë rajonit të Gjiçanit, Kamenicës dhe Vitisë pas tërmetit, është realizuar . Ai me këtë rast theksoi se për angazhime të jashtëzakonshme që ka bërë, falënderon kryetarin e Parlamentit dhe Ministrinë përkatëse që këto mjete, më në fund, t' i marrin institucionet dhe ata qytetarë dhe familje të cilët kanë qenë më së shumti të rrezikuar.

Unë, së bashku me deputetët e këtij Parlamenti, nga ky rajon , do të kemi një takim të shtunën e ardhshme me udhëheqësit e këtyre tri komunave, në mënyrë që këto mjete vërtetë të menaxhohen dhe shkojnë në drejtim të caktuar në rindërtimin e institucioneve, por edhe tek ato familje për të cilat ka marrë vendim ky Kuvend.

Kryetari i Kuvendit , Nexhat Daci tha se ky është lajm i mirë , se më në fund, vendimet fillojnë të realizohen. Ndoshta me vonesë, megjithatë, kjo vërteton se asnjë vendim i marrë nuk do të mbetet pa u realizuar, pohoi profesor Daci .

Reformimi i sistemit zgjedhor në Kosovë dhe pozita e gruas



Nafije Gaj

Sistemi i kaluar zgjedhor në Kosovë kishte të mirat dhe të këqijat e veta edhe nga fakti se asnjë model i pastër zgjedhor, nuk i përmbush të gjitha kriteret që i kërkon një shoqëri demokratike dhe nuk i sendërton të gjitha synimet edhe për të gjitha grupet, si gjinore ashtu edhe etnike e poashtu edhe për grupet shtresore, si dhe për përfaqësimin adekuat rajonal etj. Qëllimi i zgjedhjeve është që në strukturat qeveritare, pushtetore, të përfaqësohet numër sa më i madh dhe sa më përfshirës i të gjitha atyre elementeve që e përbëjnë shoqërinë e një vendi, por që edhe ky përfaqësim të jetë në proporcion të drejtë me efikasitetin e qeverisjes e me marrjen e vendimeve.

Të ruhet kuota e 30 përqindshimit të obligueshëm e përfaqësimit të femrave
Duke pasur parasysh gjendjen e menjëhershme të Kosovës të dalë nga lufta dhe pasojat që la, dhe duke dashur një qetësi të përgjithshme, strukturat ndërkombëtare e në rend të parë OSBE-ja, duke pasur në këtë vështrim edhe përvojën nga vendet e tjera, sistemi zgjedhor në Kosovë u përcaktua sipas sistemit proporcional dhe me lista të mbyllura. E

Me Kornizën Kushtetuese të Kosovës janë paraparë, si të themi çelësa të ndryshëm në zgjedhje të organeve për të siguruar përfaqësim të normuar të etnive të ndryshme, mirëpo këso çelësash nuk janë paraparë për përfaqësimin e femrave, kështu që numri i femrave në strukturat udhëheqëse të organeve nuk i përgjigjet strukturës së përgjithshme të femrave të zgjedhura, madje fare nuk i përgjigjet edhe strukturës së përgjithshme të femrave në shoqëri

mira e këtij sistemi është se u përfaqësuan me shumë grupime politike në Kuvendin e Kosovës, gjithsejt 14 parti e grupime politike nga 120 deputetë sa i ka Kuvendi, u përfaqësuan etnitë e ndryshme dhe nacionalitetet kombëtare, me gjithsejt shtatë parti politike që përfaqësojnë nacionalitetet e ndryshme përveç shqiptarëve.

Sistemi proporcional në Kosovë siguroi edhe një qetësi efektive politike që kushtëzoi një koncensus partiak për qeverisje, aq shumë të nevojshëm në nismat e para të ndërtimit të sistemit demokratik dhe në sigurimin e një qetësie politike. Në këtë bazë u ndërtua Qeveria e Kosovës dhe të gjitha institucionet e tjera dhe tash në Kosovë, në këtë qeverisje të parë trevjeçare nuk kemi pozitë dhe opozitë klasike dhe në këtë bazë nuk kemi tensione politike gjatë marrjes së vendimeve.

Sistemi zgjedhor në Kosove, megjithëse proporcional, ishte i mbuluar edhe me disa cenzuse që i evitonin dobësitë e një sistemi të tillë të pastër. U caktua kushti prej tridhjetë për qind femrash të zgjedhura, dhe cenzusi prej 20 deputetësh nga nacionalitetet e tjera në kuadër të të cilit numër 10 u siguruan për nacionalitetin serb.

Gjithashtu me Kornizën Kushtetuese të Kosovës janë paraparë, si të themi çelësa të ndryshëm, në zgjedhje të organeve për të siguruar përfaqësim të normuar të etnive të ndryshme, mirëpo këso çelësash nuk janë para-

parë për përfaqësimin e femrave, kështu që numri i femrave në strukturat udhëheqëse të organeve nuk i përgjigjet strukturës së përgjithshme të femrave të zgjedhura, madje fare nuk përgjigjet edhe strukturës së përgjithshme të femrave në shoqëri. Prezentimi i femrave në strukturat e zgjedhura në Kosovë, si në nivelin lokal ashtu edhe në atë qendror, duhet në një formë të jetë i garantuar, që asesi nuk do të thotë se femrat në bazë të zgjedhjeve të lira nuk mund ta tejkalojnë këtë cenzus. Unë edhe më tej jam për atë që të ruhet kuota e 30 përqindshimit të obligueshëm të përfaqësimit të femrave, madje që në një mënyrë kjo të garantohet edhe në përfaqësimin në organet e larta, si për shembull, nëse një parti i fiton tri vende ministrash atëherë një vend të jetë i obligueshëm të plotësohet me një femër.

Cili do të ishte modeli ideal?
Për shkak të shumë rrethanave të barta nga e kaluara, për shkak të angazhimeve të femrave në punët tradicionale, për shkak të botëkuptimeve të vjetra, femra jonë në Kosovë nuk është e barabartë me mashkullin, as sa i përket nivelit të shkollimit as sa i përket shkallës së punësimit. Femra, si në çdo shoqëri tjetër, edhe në Kosovë përbën gjysmën e popullsisë, por niveli i punësimit është më pak se 25 për qind, e gjithashtu edhe niveli i shkollimit të lartë, është tejet i vogël.

>>>>

Fatmir Sejdiu priti drejtorin e ECMI-it, Mark Weller

Në tërë procesin e hartimit dhe të aprovimit të ligjeve Kosova mëton të ofrojë zgjidhje që do të jenë në pajtim të plotë me standardet e legjislacionit evropian

Kuvendi i Kosovës në bashkëveprim me Qeverinë, në tërë procesin e hartimit dhe të aprovimit të ligjeve, mëton të ofrojë zgjidhje që do të jenë në pajtim të plotë me standardet e legjislacionit evropian. Në këtë vështrim synohet gjithnjë edhe plotësimi i standardeve që kanë të bëjnë me sigurimin e të drejtave të njeriut dhe të drejtave të minoriteteve. Ky do të ishte edhe një segment tejet i rëndësishëm në kuadër të të gjitha përpjekjeve që bëhen në Kosovë për të qenë në proces të gjithë së bashku, sepse vetëm kështu qytetarët do të ndihen në vendin e vet. Gjithë kjo edhe nga fakti që Kosova në synimet e saj për pavarësi synon të jetë pjesë e Evropës.

Këto ishin disa nga konstatimet thelbësore të takimit që pati anëtarë i Kryesisë së Kuvendit të Kosovës, Fatmir Sejdiu me z. Mark Weller, drejtor i ECMI-it (Qendra Evropiane për Çështje

Minoritare) dhe Robert Cuis, shef i kësaj zyre , në të cilin temë bosht ishte ndihma që do të ofrojë kjo qendër në fushën e legjislacionit, duke filluar që nga hartimi i projektligjeve . Z. Maks Weller premtoi një ndihmë të vazhdueshme në tërë procesin e legjislacionit që do të kalojë nëpër trupat e Kuvendit.

Fatmir Sejdiu në takimin me z. Weller foli edhe për procesin e plotësimit të Kornizës Kushtetuese për të eliminuar atë që nuk është në përputhje me kohën, meqë aty ndeshen edhe formulime dualiste. Duke i bërë një vështrim nevojës së bartjes së kompetencave , Sejdiu theksoi se bartja e tyre krijon hapësirë që detyrat të kryhen me përgjegjësi, mirëpo deri tash në këtë fushë ka pasur hezitim nga faktori ndërkombëtar, kundruall dëshirës që të dëshmohej në pajtim me përgjegjësitë që marrim , theksoi Sejdiu.

TAKIM I ZYRTARËVE AMERIKANË ME KRYETARËT E KOMISIONEVE PËR TË ZHDUKURIT TË KOSOVËS

Vështirësi të shumta në mungesë të kompetencave

Kryetarja e Komisionit Parlamentar për Persona të zhdukur, Flora Brovina dhe kryetari i Komisionit Qeveritar të Kosovës, Habit Hajredinaj, patën një takim me të deleguarin e Stejt Departamentit Amerikan nga Zyra për demokraci dhe çështje humanitare, Ireneo Bong Miquiabas, si dhe me zyrtarin politik , i cili do të merret me problematikën e personave të zhdukur në Zyrën Amerikane, David A. Holms. Me këtë rast zyrtarët amerikanë u njoftuan me çështjen e të zhdukurve, të rrëmbyer nga forcat shtetërore serbe , të cilët tash e më shumë se katër vite kërkohen nga familjet kosovare. Çështja e identifikimit të kufomave , procesi i ngadalshëm i përcjelljes së kufomave, pasi të jenë kryer të gjitha procedurat, përbëjnë një problem tejet të dhembshëm , i cili kërkon zgjidhje. U vunë në spikamë edhe vështirësitë me të cilat po ballafaqohen këto dy komisione në mungesë të kompetencave. Zyra për persona të zhdukur e UNMIK-ut, jo vetëm që i ka të gjitha kompetencat, por ajo palën vendëse nuk e konsideron as si partner. Nga ana e zyrtarëve amerikanë u shpreh mendimi se bisedimet Prishtinë – Beograd mund të ndikojnë në zbardhjen e fatit të të zhdukurve. Pala vendëse, në këtë takim, shtroi kërkesën që të zhvillohen bisedime me UNMIK-un, që të merren kompetencat nga ana e këtyre komisioneve, në mënyrë që pala kosovare të jetë e barabartë me palën serbe në këtë çështje aq të rëndë.

<<<<

Për këtë duhet pasur kujdes që përfaqësimi i femrës të mos jetë në dëm të cilësisë. Të mos futemi sa për numër, por vërtet nëse mund të kontribuojmë, nëse kemi kualifikime e aftësi përkatëse, nëse kemi mundësi të angazhimit të rregullt dhe nëse në çdo aspekt japim kontributin tonë në rrjedhat politike dhe të tjera, duhet edhe të angazhohemi e përfaqësohemi njëjtë me mashkullin.

Cilësia nuk është vështirë të sigurohet për atë se përfaqësimi në numër,

në strukturat e zgjedhura në të gjitha nivelet është shumë i vogël në përqindje, dhe mund të plotësohet me femra, të afta, të shkolluara, që dinë gjuhë, që kanë vullnet dhe që kanë kohë të merren me punët politike dhe shtetërore e t' i kryejnë ato me sukses.

Cili atëherë do të ishte modeli ideal i zgjedhjes? Përgjigje krejt ekzakte në këtë nuk mund të ketë, por më i miri është ai model i cili i respekton veçantitë tona, dhe mundëson edhe përfaqësim gjinor, edhe etnik e fetar,

edhe rajonal edhe shtresor dhe profesional. Për t' u arritur cilësia e diniteti veprues kuptohet se votimi duhet të jetë me lista të hapura, por në këtë duhet pasur kujdes që kjo mos të shkojë në dëm të përfaqëimit rajonal , pasi kjo te grupet e minoriteteve mund të ndodhë, duke pasur parasysh shtrirjen gjeografike të tyre, veçanërisht të grupit nacional turk.

Nuk dua të përsëris që emancipimi femrës sjell emancipimin edhe të gjithë shoqërisë.

Qeveria as s'e ka nënçmuar, por as nuk e ka predimensionuar dialogun me Serbinë

Në fillim të seancës së 2 tetorit të këtij viti, kryetari i Kuvendit të Kosovës Nexhat Daci i njoftoi deputetët për kontaktet shumë intensive lidhur me rendin e ditës. Ai tha se kanë arritur dy shkresa një nga zoti Solana dhe një nga Grupi i Kontaktit, përmbajtja e të cilave është e njëjtë: kërkohet sjellje e përgjegjshme e përfaqësuesve në institucione. Përkujtohet se janë marrë marrë obligimet në Samitin e Selanikut në qershor dhe në një mënyrë shpjegohet ajo që mediat e kanë pasur. Edhe bisedat tjera telefonike janë të këtij niveli dhe të kësaj përmbajtjeje

Përkitazi me pikën: Shqyrtimi i propozimit të Qeverisë lidhur me marrjen e qëndrimit për bisedimet e mundshme Kosovë – Unioni Serbi Mali i Zi fjala iu dha kryeministrit të Kosovës, **Bajram Rexhepi**. “Dialogun me Serbinë, si një nga tetë standardet nga ish - kryeadministratori Shtajner dhe të përkrahura nga institucionet relevante ndërkombëtare, Qeveria e Kosovës nuk e ka nënçmuar asnjëherë, por as nuk e ka predimensionuar. Kjo çështje, disa herë është trajtuar në Qeveri në mënyrë që, nëse vjen deri te dialogu, të jemi sa më të përgatitur”, theksoi Rexhepi.

Të transferohen sa më shumë kompetenca në qeveri

Me të drejtë kemi kërkuar vazhdimisht që të transferohen sa më shumë kompetenca në Qeveri, që të shtohet funksionaliteti dhe efikasiteti kundruall pritjeve reale të qytetarëve të Kosovës, përmbushjes së standardeve, e në kuadër të tyre, edhe të dialogut. Në këtë aspekt, deri më tani, kemi hasur në mosgatishmërinë nga ana e UNMIK-ut”, theksoi Bajram Rexhepi. Në vazhdim kryeministri njoftoi të pranishmit se me ardhjen e kryeadministratorit Hari Hollkeri, në takimin e parë zyrtar, më 26 gusht 2003, në formë të shkruar, ia ka dorëzuar kërkesat minimale për themelimin e disa zyreve në Kryeministri, si hap i parë drejt ministrive të ardhshme. Por, përveç premtimit gojor – se do të shqyrtohen seriozisht, edhe pas më shumë se dy muajsh, nuk është marrë përgjigje decisive.

Në ndërkohë, Parlamenti i Serbisë dhe ai i Unionit Serbi - Mali i Zi ka aprovuar deklaratën kushtetuese, e cila Kosovën e pozicionon juridikisht si pjesë e Serbisë: Shkelje e Rezolutës 1244!? Reagimi i institucioneve relevante ndërkombëtare ka qenë, si zakonisht, i butë dhe në formën: se asnjë akt unilateral i Serbisë ose i Kosovës nuk do të ketë ndikim në Rezolutën 1244!? Kjo paraqet një vështirësi gati të pakalueshme për suksesin e çfarëdo

bisedimeve me Serbinë, goftë edhe për çështje praktike. Me të drejtë kemi pritur, theksoi Rexhepi, se kryeadministratori i ri do t'i ketë prioritete problemet aktuale të cilat e rëndojnë Kosovën, si: zhvillimin ekonomik dhe gjetjen e rrugëve për huazime nga institucionet financiare ndërkombëtare dhe perspektivën e hapjes së vendeve të punës; integrimin e komuniteteve minoritare; ngritjen e efikasitetit të shërbimit policor dhe të gjyqësisë; respektimin e rendit dhe ligjit; angazhimin e përbashkët për zgjidhje sa më të pranueshme për kategoritë sociale – arsimtarët, punëtorët shëndetësorë, pensionistët, invalidët e tjerë.

Si e papritur, tërë energjia e tij është koncentruar në dialog me Serbinë, duke siguruar mbështetjen e institucioneve relevante ndërkombëtare. Ndërsa, për institucionet vendore, është menduar se është e vetëkuptueshme që ato do të marrin pjesë në dialog në çfarëdo forme, kohe dhe mënyre.

Në ndërkohë, Serbia cakton si palë biseduese Qendrën Koordinuese, me në krye nënkryetarin e Serbisë, Nebojsa Çović, aktiviteti destruktiv i të cilit është i njohur në dy-tri vitet e fundit, ndërsa delegacioni kosovar do të udhëhiqet nga kryeadministratori. Me këtë formë vetëm se legjitimohet marrëveshja Hakerup-Çović dhe bisedimet do t'i ngjanin bisedimeve në grupin e lartë të punës “Hajrenki-group”.

Kemi besuar edhe në premtimet e dhëna si më herët, e veçanërisht që nga dita e parë e ardhjes së kryeadministratorit të ri për eliminimin e institucioneve paralele serbe. Fatkeqësisht, deri më tani, gjërat në terren as për një grimë nuk kanë lëvizur në drejtim të ushtrimit të pushtetit unik, goftë në lëmin e arsimit, shëndetësisë, administratës, transportit e komunikacionit, apo aspektet tjera të kompetencave të bartura në mbarë territorin e Kosovës.

Të gjitha këto, e shumë të tjera, kanë qenë rrethana tejet rënduese që Qeveria të marrë vendim vetjak. Qeveria e koalicionit, e bazuar në Marrëveshjen e 28 shkurtit 2002, duke qenë e përgjegjshme ndaj qytetarëve të vet, subjekteve politike dhe Parlamentit, ka diskutuar dhe ka vendosur për këtë:

Në vazhdim të mbledhjes së rregullt të 70-të të Qeverisë, të datës 27 shtator 2003, vendimi unanim i Qeverisë i është përcjellë Kuvendit të Kosovës që për çështjen e dialogut të merret vendim politik nga ana e Parlamentit, ku do të merret pjesë edhe Qeveria, me të gjithë ministrat dhe të japim kontributin tonë, me sqarimet eventuale.

Pikat e vetme të propozuara, qysh nga zoti Shtajner, dhe të aprovuara në Samitin e Selanikut, për momentin janë: kthimi i të zhvendosurve, personat e zhdukur, energjetika e transporti dhe telekomunikacioni. Dy nga këto pika janë

plotësisht të rezervuara - kthimi dhe personat e zhdukur, ose të pagjetur. Ndërsa, energjetika dhe transporti janë përgjegjësi të gërshetuara ndërmjet institucioneve vendore dhe atyre të UNMIK-ut.

Kryeministri dhe Qeveria në përgjithësi, nuk janë të gatshëm të marrin pjesë në bisedime me Beogradin pa një vendim pro të Parlamentit dhe, domosdoshmërisht, duke përfshirë konsensusin e tri grupeve parlamentare të subjekteve politike – nënshkruese të Marrëveshjes së 28 shkurtit 2002 për Qeverinë e Kosovës, tha Bajram Rexhepi .

Pas kësaj fjale , z. Nexhat Daci njoftoi të pranishmit se kishte arritur një sqarim sipas të cilit është vendosur që Hari Hollkeri, e udhëheq vetëm delegacionin e UNMIK-ut, ndërsa delegacionin e institucioneve të Kosovës e udhëheqin institucionet, sipas marrëveshjes së vet.

Të sillemi në nivelin e përgjegjësive politike

Duke marrë fjalën shefi i Grupit parlamentar të LDK-së **Sabri Hamiti** theksoi se dëgjuam artikullimin e kryeministrit të Kosovës lidhur me një çështje, për të cilën kemi biseduar edhe dy javë më parë në këtë sallë. Ne nuk do të kishim asgjë të shtonim të re nga ajo që kemi thënë para dy javësh. Aq më tepër, shumë theksime nga fjala e kryeministrit duken sikur citat i asaj që është thënë para dy javësh këtu. Në këtë kuptim, ne shohim një tip të pëlqimeve të brendshme rreth situatave politike në të cilat ndodhemi.

Nga ana tjetër, ne dëgjuam këtu një prononcim të kryeministrit, jo shumë të qartë çka kërkohet sot prej Parlamentit. Unë kërkesën, pos mëdyshjeve rreth mundësisë së dialogut, kërkesën qartas nuk e kuptova, totalisht. Është mirë të dihet botërisht që përfaqësues të institucioneve të Kosovës, që nga Samiti i BE-s në Selanik e tutje, në mënyrë së paku deklarative publike, kanë thënë se janë zotuar për dialogje me fqinjët, natyrisht duke përfshirë edhe Unionin Serbi - Mali i Zi, që është fqinji ynë. Kjo është nën një.

Nën dy. Këta përfaqësues të institucioneve, por edhe të partive relevante politike të Kosovës, sa herë kanë biseduar me eksponentë të politikës ndërkombëtare, së paku publikisht, unë qysh i kam parë, kanë thënë se janë për këtë dialog. Kjo është e evidente dhe këtë e di gjithkush, qysh e di edhe unë.

Unë kisha dëshirë që të sillemi në nivelin e përgjegjësive politike dhe udhëheqëse dhe definitivisht, sidomos njerëzit me përgjegjësi të lartë udhëheqëse, të flakin sa të jetë më e mundur hipokrizinë politike dhe qëndrimet e formuara politike institucionale t'i mbrojnë njësoj – si në dyert e mbyllura, si në kontaktet sy më sy , si në kontaktet publike para zgjedhësve. Unë kujtoj që kjo është një domosdo e njerëzve përgjegjës në situatat ideale shoqërore, po aq më shumë në situatat që nuk janë ideale shoqërore.

Kuvendi ynë nuk ka arsye, arsye politike, të jetë kundër dialogjeve. Mirëpo, Kuvendi ynë është kaq i

përgjegjshëm sa që nëse dialogu është një standard i ashtuquajtur i artikulluar nga Shtajneri, i përkrahur nga institucionet tjera ndërkombëtare në Kosovë e jashtë saj, atëherë nëse standardi është një standard dialogu, atëherë edhe dialogu duhet të ketë standarde.

A i ka ky dialog standartet paraprake? Unë do të thosha: - jo. 1. Temat e propozuara, dy prej tyre, janë tema që unë, kujtoj, s' duhet të bisedohen hiq. Sepse, problemi i përgjegjësive për të zhdukurit në luftë, sanksionohet me konventa ndërkombëtare dhe ato janë të obligueshme: – shtetet që t'u përgjigjen. 2. Tema tjera të propozuara janë gjysmë-gjysmë. Dhe, këtu tash vjen problemi i përgjegjësive: UNMIK – Qeveri e Kosovës, që unë e kam thënë herën tjetër: është qeveri dykrençe, që është përgjegjësi të cilën nuk mund t'ia japim ne Qeverisë të plotë, por nuk mund t'ia japë as UNMIK-u. Domethënë është një problem i ndarë gjysmë-gjysmë. Kjo mund të ndodhë vetëm me marrëveshje të fortë në mes të Qeverisë sonë dhe të UNMIK-ut, para se të fillojë një dialog i mundshëm për probleme konkrete.

Dhe, në fund: Nëse nevojitet një dialog për një fotografi të përbashkët, si dëshmi se njerëzit mund të shihen në një tavolinë dhe të fotografohen, unë e konsideroj të padobishëm. Sepse, është lojë! Nëse është nevoja imanente e shoqërisë së Kosovës që të bisedohet për probleme të qytetarëve, - po. Mirëpo, nuk ka kurrfarë interesi konkret qytetar në Kosovë, sot, që mund të plotësohet në rast se prishet perspektiva politike e atij qytetari, theksoi Hamiti.

Bashkësia ndërkombëtare nuk ka marrë veprime konkrete institucionale që ta parandalojë Serbinë në tentativat e agresionit kushtetues

Arsim Bajrami, theksoi se tema që sot po e diskutojmë, është ndër temat më të rëndësishme politike dhe kërkohet prej nesh një përgjegjësi e lartë, një përgjegjësi e lartë që do të shprehë edhe autoritetin që kemi. Siç dihet Kosova, edhe në prononcimet përmes institucioneve, gjithmonë ka përkrahur një politikë të bashkëpunimit, një politikë të fqinjësisë së mirë me të gjitha shtetet e rajonit, duke përfshirë këtu edhe Serbinë.

Mirëpo, siç dihet, Kosova po ecën shumë ngadalë në implementimin e Rezolutës 1244 dhe, do të thoja, në përgatitjen e saj për zgjidhjen finale të statusit të Kosovës, që është edhe një nga obligimet parësore të UNMIK-ut dhe të Kombeve të Bashkuara, pra për të lehtësuar një zgjidhje politike, për një zgjidhje finale të statusit të Kosovës. Dhe, në kushtet kur Kosova, shumë ngadalë po mveshet me kompetenca dhe shumë ngadalë po merr përgjegjësi për të dëshmuar aftësitë e veta qeverisëse, nga Kosova kërkohet të hyjë në një proces me Serbinë, në kondita krejt të pafavorshme dhe të pabarabarta për dy arsye: E para, për shkak se Serbia ka koncipuar një politikë shtetërore agresive ndaj Kosovës, duke kryer, duke tentuar bërjen e agresionit kushtetues përmes akteve kushtetuese.

[/ vijon në faqe 18 /](#)

Dhe, e dyta, për shkak se Kosova shkon me një pozicion shumë të pabarabartë, pra pa kompetenca dhe me një përfaqësim që, do të thojë, nuk është krejt i barabartë.

Në anën tjetër, bashkësia ndërkombëtare, e cila ka vënë një nga standardet – bisedat me Beogradin, mendoj se shumë ngadalë – shumë ngadalë ka përgatitur Kosovën që të formojë një identitet politik dhe juridik; shumë ngadalë po e implementon Rezolutën 1244 dhe tani po hyjmë në vitin e pestë të implementimit të kësaj Rezolutive, – Kosova është ajo që ishte në kohën e miratimit të kësaj Rezolutive, pa kompetenca, do të thojë, pa mundësi të shprehjes së identitetit të vet.

Në anën tjetër, bashkësia ndërkombëtare, përpos deklarimeve verbale, që i dëgjuam edhe dje nga zoti Solana, nuk ka marrë veprime konkrete institucionale, do të thojë, edhe veprime ligjore, që në një mënyrë ta parandalojë Serbinë në këto tentativa të agresionit kushtetues dhe nuk ka marrë një veprim shprehimor çfarë ka qenë e mundshme për t'i shpallur të pavlefshme ndaj Kosovës dhe për të mundësuar, që në një fazë të mëvonshme të mundësohet një zgjidhje demokratike e statusit të Kosovës. Në këtë kontekst, mendoj se duhet të shikojmë realisht – a është Kosova apo s'është e përgatitur për këto biseda.

Dragisha Kërstoviq, shef i Grupit parlamentar “Kthimi”, theksoi se: Tërë ajo që është arritur me ndihmen e misionit ndërkombëtar, për zgjidhjen e problemeve dhe rregullimin e gjendjes në Kosovë, nuk ka dhënë rezultate me të cilat do të ishim të kënaqur. Mu për këtë arsye, mendojmë se bisedimet në mes të Bashkësisë shtetërore të Serbisë e Malit të Zi dhe Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, janë shansë reale që këto probleme të zgjidhen në mënyrë që Kosova të ketë një ardhmëri më të mirë, në drejtim të krijimit të kushteve për një jetë të qetë dhe të sigurtë për të gjithë njerëzit, që të kaluarën ta lëmë pas dhe se për të gjitha t'i përmbahemi....të bashkohemi me popujt e civilizuar dhe shoqëritë e Evropës dhe botës.

Sa më parë që ta kuptojmë këtë, aq më parë të kaluarën dhe të tashmen do ta lëmë pas, për t'u kthyer në një ardhmëri më të sigurtë dhe më të mirë. Prandaj, mendojmë se edhe bisedimet për tërë këtë nuk kanë alternativë dhe se janë rast i mirë të hecimit drejtë ardhmërisë në këto hapësira.

Nëse e lëshojmë këtë rast dhe nëse qasja jonë në bisedimet me Bashkësinë shtetërore të Serbisë e Malit të Zi dhe Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë do të jetë diçka tjetër dhe nëse këtyre bisedimeve u japim kahje të gabuar, të cilën gjë mund ta bëjnë politikanët e gabueshëm, atëherë kjo përditshmëri e rëndë do të jetë shumë më e gjatë, kurse ardhmëria vazhdimisht do të na mungojë.

Grupi parlamentar i koalicionit “Kthimi” përshendet përprjekjet e Bashkësisë ndërkombëtare për fillimin e bisedimeve dhe konsideron se ky është rast për kthesë të madhe në krahasim me gjendjen e tanishme, dhe se bisedimet e drejta dhe të sinqerta mund të na shpiejnë drejt afrimit dhe pajtimit të bashkësive në Kosovë, para së

gjithash bashkësisë shqiptare dhe serbe.

Mu për këtë arsye, ju ftoj të provojmë të bisedojmë, ta ndërtojmë atë që shumë popuj tjerë ka herë e kanë dhe të bëhemi udhërrëfyes të epokës së re për Kosovën. Ky është rasti më i mirë për ne.

Bisedat teknike janë improvizim për shumë shkaqe

Ramush Haradinaj, në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, theksoi se përgatitjet për këto biseda teknike janë improvizim për shumë shkaqe, për shumë arsye. Në radhë të parë, askush nga ne nuk ka një plan me detaje, me



gjithçka, një skemë se si do të fillonim. T'ua jap vetëm një shembull pse janë improvizim? Zoti Hollkeri vjen me delegacionin e Kosovës, qoftë si kryesues i delegacionit, qoftë si ndërmjetësues: “U mbajt takimi i parë, simbolik, u shtrënguan duart, përfundoi!” Cila është adresa jonë pastaj? Kujt i drejtohem ne për të ditur, për të pyetur, shprehur e sqaruar rreth çështjes së bisedimeve?

Ne jemi deklaruar edhe në këtë foltore: kërkojmë një ndërmjetësues serioz, relevant ndërkombëtar; një adresë që, pastaj edhe pas takimit të parë simbolik, të dimë cila është adresa jonë dhe kemi thënë se duhet të jenë përfaqësuesit e Qeverisë Amerikane, qofshin këto simbolike, qofshin çfarëdo - është në nderin tonë dhe në moralin tonë t'i ftojme këta njerëz edhe për të qenë prezent; vetëm për të vëzhguar, t'u bëjmë një nder kur dimë se bashkësia ndërkombëtare ishte e udhëhequr nga këta në momentet kur u vë në mbrojtje dhe në ndërprerje të konfliktit në Kosovë. Të merren njerëzit e Kosovës, liderët e institucioneve në këtë rast, në një takim të këtillë, pa iu thënë sakt detajet e kësaj – nuk është në rregull. Nuk është në rregull të vijë një kërkesë në Parlament për biseda pa një skemë, pa u ditur sakt kush-e-kush në çdo aspekt. Dhe si mund t' i japim ne mbështetje bisedave të këtilla kur kemi kaq paqartësi.

Edhe një aspekt tjetër, që i bën improvizim këto biseda. Improvizim në kuptimin e plotë të fjalës: Zoti Hollkeri thotë se ka ndërtuar “task fors”, pra ka ndërtuar një ekip, një grup pune për të pasur sukses bisedat. Kush i zhvillon këto biseda, atëherë? A i zhvillon UNMIK-u, qeveria e UNMIK-ut apo Qeveria e Kosovës? Në rast se është Qeveria e Kosovës, në rast se kryetari i Kosovës duhet të marrë pjesë, kryeministri dhe t’ia shtrëngojë dorën palës tjetër, këta duhet t’i kenë “task forsat” dhe nuk është mandati i zotit Hollkeri t’i përforcojë, t’i rrisë kapacitetet e bashkësisë ndërkombëtare në Kosovë, por është që t’i zvogëlojë ato dhe të gjitha këto përgjegjësi t’i kalojë tek institucionet vendore. Pra, mandati i tij është të ndërtojë kapacitetin e institucioneve të Kosovës. Ne ia kemi shprehur këtë kërkesë nga dita e parë. Edhe pse e kemi kuptuar se ai i ka nxjerrë në prioritet bisedat teknike me Beogradin, nuk kemi dashur që t’i pengojmë dhe t’i bllokojmë këto biseda, gjithnjë me shpresën se Hollkeri e kupton se ne gjykojmë atë vetëm sa ai bën ne drejtim të rritjes së kapaciteteve të institucioneve të Kosovës, të Qeverisë së Kosovës, sa ai bën për t’iu dhënë mundësi institucioneve të Kosovës të aftësohen për biseda të mundshme.

Meqenëse ai nuk ka shprehur asnjë fije respekti deri më sot, asnjë përfillje të njerëzve tanë të institucioneve, ne nuk mund të jemi të këtuillë që t’i japim një “po” bisedave të kësaj forme. Është një improvizim i plotë që ka ndodhur! Ta marrim një shembull tjetër: pse pengohet në Kosovë të ketë ministri të rendit, ministri të drejtësisë - kur e dimë se edhe krahinat nëpër shtete, qofshin federale, qofshin tjera, kanë ministri të rendit. Meqenëse këto biseda janë teknike, çfarë po thuhet se janë, atëherë të aftësohet Kosova, të paktën, në ata lëmenj që ende nuk i japin atributin e shtetit. E kuptojmë se ka më shumë vështirësi për ministrinë e mbrojtjes, për ministrinë e jashtme. Por, që të mos lëvizet, në këto aspekte, nuk ka më kuptim!

Unë mendoj se Parlamenti i Kosovës nuk duhet t’i japë “po”-në Qeverisë përderisa Qeveria nuk sjell në këtë Parlament kërkesën për aprovim të Qeverisë së kompletuar.

Sadik Idrizi theksoi se bashkësitë tjera do ta përkrahin qëndrimin e shumicës në Parlamentin e Kosovës për dialogun eventual në mes të Prishtinës e Beogradit. Nëse vie deri te dialogu, bashkësitë tjera dëshirojnë të inkuadrohen në bisedime, për shkak se kanë probleme specifike.

Kemi nevojë për një dialog të brendshëm **Xhavit Haliti**, shprehu mendimin se në përgjithësi politika e Kosovës, politikanët, grupet parlamentare, subjektet në përgjithësi pa dallim, edhe përfaqësimi nacional, janë deklaruar që nuk janë kundër dialogut me shtetet fqinj. Po para se të themi – me shtetet fqinje, do të duhej ta pyesnim vetëveten se çka jemi ne dhe çfarë përfaqësojmë ne në këto bisedime.

Prandaj, në këtë drejtim do të shtroja disa çështje të cilat janë ngritur gjatë këtyre ditëve gjatë debateve të organizuara në Serbi dhe që te ne nuk kanë qenë prezente, si dhe mendimin tim se a duhet apo s’duhet të bisedojmë në

këto rrethana .

Deri më tani, të gjithë përfaqësuesit zyrtarë të Serbisë janë deklaruar që “ne do bisedojmë me pjesën tonë”, me “krahinën tonë” dhe në asnjë mënyrë nuk do të bisedojmë me një vend fqinj qysh po kemi qef ne dhe qysh po deklarohemi nganjëherë akoma pa e definuar çështjen tonë.

Në vijim Haliti tha se i kemi djegur “anijet” për të udhëtuar për Beograd. Kushdo që të mendojë ndryshe, e ka gabim. Kushdo që përpiqet të ndërtojë ndonjë trap për t’u rikthyer atje, e ka gabim. Se, ai trap do të fundoset.

Prandaj, mendoj që bashkësia ndërkombëtare dhe Serbia, dhe ne këtu si deputetë, do të duhej të kërkonim që me Serbinë të nënshkruajmë si Kosovë një marrëveshje paqe në mes dy vendeve tona, duke kërkuar fillimisht që Serbia t’i tërheqë forcat e saj të armatosura në kufi me Kosovën, që nuk e dimë pse po i mban, sepse agresion nga Kosova nuk ka. Marrëveshja e paqes në mes Kosovës dhe Serbisë, formale le të jetë ajo, do të ndikojë në vazhdimin e bisedimeve për interesa të përbashkëta të të dy vendeve.

Kryeparlamentari **Nexhat Daci** njoftoi në vijim deputetët se në bisedë me zotin Hollkeri i kam shtruar një dilemë dje, sepse kontaktet e mia me grupet parlamentare, me Kryesinë në ndërtesë dhe jashtë ndërtesë, kanë qenë vërtetë intensive dhe kam shprehur dilemën a e vlen që një unitet funksional i arritur me shumë mund për një vit e gjysmë në Parlament dhe në Qeveri, që me një shpejtësi të madhe të konsumohet pa i analizuar mirë rrjedhat e nesërme , fjala është për funksionimin e Qeverisë, që ndoshta shpeshherë pa vend ky Parlament i ka dhënë besim enorm të madh me një dëshirë pozitive që të kemi rezultate. Këtë hamendje timen e ka shtuar edhe më tepër shkresa e Grupit të Kontaktit dje. I kam theksuar sjelljet në bashkësinë ndërkombëtare dhe këtë kryetarit të Parlamentit të Evropës në takimin tim, që sot po e bëj publike. I kam thënë: “Si mund ta ruajmë unitetin funksional, në qoftë se institucioni më përgjegjës i Evropës ose ndër më përgjegjësit – Asamblea Parlamentare e Këshillit të Evropës i lejon përfaqësuesit të Serbisë që të thotë të gjitha të zezat për Kosovën, për institucionet e saj dhe për bashkësinë ndërkombëtare në Kosovë, ndërsa ne nuk e kemi atë të drejtë as fizike që t’i ofrojmë bashkësisë ndërkombëtare argumente të kundërta.” Do të thotë një qasje plotësisht – plotësisht diskriminuese!

Prandaj, ju kërkoj mirëkuptim, në qoftë se ka nevojë edhe ta votojmë, që t’i japim shansë konsensusit aq të nevojshëm politik në Kosovë dhe, mbi të gjitha, konsensusit parlamentar, sepse këtë Parlament e presin detyra shumë të rëndësishme dhe i lus partitë politike që do ta humbin takatin deri në vjeshtën e ardhshme, sepse shumë herët e kanë filluar fazën paraelektorale, por në mënyrë institucionale, siç jemi të përgjegjshëm këtu.

Prandaj, unë, me lejen tuaj, e nëse doni edhe votojmë, do ta përmbyllja këtë seancë për shkak të tensionimit të brendshëm të secilit nga ne dhe do t’i vazhdojmë ligjet në seancën e ardhshme plenare. Më pas deputetët aprovan më shumicë votash këtë propozim të kryetarit të Kuvendit të Kosovës.

Aprovohen disa amendamente në Regulloren e Punës së Kuvendit të Kosovës

Në mbledhjen e Kuvendit të Kosovës të 9 tetorit, duke marrë fjalën rreth shqyrtimit të rekomandimit të Komisionit për gjyqësi, legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese për amendamentimin e Rregullores së përkohshme të punës së Kuvendit, **Arsim Bajrami** theksoi se ka kohë që në këtë Parlament është kërkuar sqarim se me cilën rregullore ne punojmë, çështje që është shtruar disa herë, por asnjëherë s'ka marrë përgjigje.

Në fakt, ne kemi miratuar Rregulloren e Kuvendit të Kosovës qysh vitin e kaluar dhe mendoj se padrejtësisht është zvarritur procedura për hyrjen e saj në fuqi. Ndërkohë, Zyra Ligjore e UNMIK-ut ka bërë disa vërejtje, për të cilat ka konstatuar se janë tejkalim i kompetencave të Kuvendit dhe bien në kolizion me Kornizën Kushtetuese.

Komisioni për çështje legjislative, i ka marrë këto vërejtje, i ka shqyrtuar, i ka diskutuar dhe ka menduar se disa nga ato duhet të pranohen, për shkak se derisa nuk bëjmë ndërrime adekuate në Kornizën Kushtetuese është e pamundshme që me rregullore të bëjmë tejkalime.

Gjithashtu, po e shihni se është shpërndarë një material i koalicionit "Kthimi". Pra, po vazhdohet me një praktikë të paraqitjes së amendamenteve në amendamente, që nuk është praktikë e mirë dhe Komisioni mendon se të gjitha këto janë të pa objekt, për shkak se këto shqetësime janë shprehur edhe në punën e Komisionit, ku kanë qenë të dy përfaqësuesit e koalicionit "Kthimi" dhe ata kanë shprehur opinionet e veta dhe disa nga opinionet e tyre janë pranuar, kështu që mendoj se janë të pa objekt. Sidomos, nuk mund të hapet çështja e Rregullores tani, për shkak se Rregullorja është votuar. Është fjala vetëm për shqetësimet që ka bërë UNMIK-u, tha Bajrami.

Të mos rilegjitimohen imponimet

Propozimet që kemi dhënë, mendojmë se nuk janë të natyrës esenciale dhe është fjala për disa ndryshime terminologjike dhe disa ndryshime që implikon domosdoshmërisht Korniza Kushtetuese.

Kërkojmë që kjo Rregullore, në mënyrë të pashtyeshme, me këto sygjerime, të hyjnë në fuqi. Dhe, të mos harrojmë, Rregullorja nuk është ligj dhe nuk kalon në fazat e procesit ligjdhënës. Nuk kalon në tri lexime. Është një akt autonom i Kuvendit të Kosovës dhe kërkojmë që, në qoftë se Kuvendi sot miraton këtë raport-rregullore, atëherë konsiderohet se hyn në fuqi qysh sot.

Kërkojmë nga Kryesia e Kuvendit që, pashtyeshëm, ta botojë Rregulloren. Ta botojë Rregulloren dhe të furnizojë të gjithë deputetët me Rregulloren e re të Kuvendit, me Rregulloren e miratuar nga ky Kuvend.

Kërkojmë, po ashtu, që të gjithë deputetët e Kuvendit të Kosovës, të pajisen me kartela të reja të identifikimit të deputetit, dhe, së fundi:

Kërkojmë që të gjithë deputetët të pajisen me librezë të imunitetit. Pra, me atë imunitet, me imunitet të kufizuar që e njeh Korniza Kushtetuese, që e njeh Rregullorja.

Kërkoj nga Kryesia, e sidomos nga Shërbimi administrativ i Kuvendit, që pashtyeshëm ta marrë këtë çështje serioze, meqenëse ne jemi në gjysmë të mandatit dhe akoma s'kemi as librezë deputeti, as librezë për imunitetin. **Hydajet Hyseni** tha se është impesive kjo procedurë jona "turbo", por nganjëherë kjo po na shkakton turbulencë, të cilat, pastaj, po na shkaktojnë marramendje që po na zgjasin gjatë, me vite ndonjëherë dhe kjo që na ka ndodhur me Rregulloren, është shembull shumë ilustrues.

Unë kam disa vërejtje, së pari parimore, që mendoj se ky Kuvend duhet t'i ketë parasysh. Ne i referohemi Kornizës Kushtetuese, do të thotë një dokumenti që është aprovuar ashtu siç

është aprovuar, është imponuar ashtu siç është imponuar, pra para se të themelohet ky institucion. Prandaj, edhe është i imponuar, që e thotë edhe shkronja e kornizës – procesi i transferit të kompetencave të institucionet, pasi ato të jenë krijuar. Për më tepër, ka pasur edhe deklarime shtesë që e kanë avancuar, së paku, deklarativisht këtë proces. Ne u informuam sot se edhe mbrëmë është premtuar se do të kompletohet, së paku, pjesërisht ekzekutivi i Kosovës. Kurse, merreni me mend, ne përpara kemi propozime që e ngrijnë, e konservojnë, madje ndonjë aspekt e kthejnë prapa këtë proces.

Prandaj, tërheq vërejtjen që ne t'i rishikojmë me vëmendje propozimet, sepse është tjetër nëse diçka i është imponuar këtij Kuvendi dhe është tjetër nëse tash ne edhe një herë e rilegjitimojmë.

Prandaj, unë kërkoj që të rishikojmë propozimin, pikën 8.6 dhe ta riformulojmë, në një mënyrë që është mendoj neutrale. Të reformulohet në përputhje me dispozitat përkatëse kushtetuese. Kjo nuk tregon asgjë nga ato që janë thënë, por nuk ia lidh duart pastaj edhe procesit të transferit të kompetencave. Mendoj që i njëjti formulim duhet të vlejë edhe për amendamentin 5. Arsyeja im është se, së pari, me Rregullore dhe me rregullat përkatëse, ne nuk bëjmë interpretimin e kompetencave të këtij e atij. Ajo bëhet me dokument kushtetues. Për më tepër, amendamenti 5 flet për transparencën dhe nuk ka asnjë logjikë që në këtë pikë, ku flitet për transparencën, ne tani edhe të përkrahim a është, siç është thënë këtu, pjesë e rezervuar dhe ju mendoni çka do të thotë pjesë e rezervuar. Për më tepër, nuk është e vërtetë se kjo është pjesë tërësisht e rezervuar. Unë i referohem këtu pikës 5.5 të Kornizës, e cila, institucioneve të Kosovës u përshkruan edhe përgjegjësi në fushën e përgatitjes për

raste të emergjencës, siç janë: të zhvillojë dhe zbatojë një strategji për planifikimin e rasteve emergjente dhe shërbimet e mbrojtjes civile. Kurse, atje ku flitet për kompetencat e rezervuara, është thënë edhe shprehimisht: përgjegjësitë për sigurinë civile dhe rastet e emergjencës do të merren gradualisht nga institucionet e vetëqeverisjes. Prandaj, mendoj që në dy këto nene duhet të evitohet mundësia e interpretimit restriktiv të dispozitave kushtetuese. Propozimi im, mendoj që e eviton këtë.

Kam edhe një vërejtje në amendamentin 2, rregulla 10, në të cilën flitet për imunitetin. Propozoj që kjo çështje të formulohet kështu: ky imunitet nuk mbulon veprime të inkriminueshme me ligj, duke përfshirë nxitjen e dhunës midis komuniteteve, racave, feve, gjinive e grupeve tjera shoqërore. Arsyetimi është ky: sepse po ta lejojmë këtë, ne inaugurojmë deliktin verbal. Është diçka që nuk haset askund.

Dy. Me propozimin ekzistues, u hiqet imuniteti, si thuhet – veprimeve që hapur propagojnë dhunën. Por, kuptohet, mundësia sikur lejohet kjo për veprime që mund të bëhen fshehur. Ose, sanksionohet në një mënyrë vetëm dhuna midis komuniteteve. E pse jo edhe midis konfesioneve, pse jo midis gjinive. Prandaj, mendoj që formulimi i tillë ka qenë që në fillim i mangët dhe nuk ka pasur logjikë të na rikthehet.

Dhe, vërejtja ime e fundit: nuk është punë e rregullores që ne ta autorizojmë Përfaqësuesin Special a merr pjesë a s'merr pjesë në seanca. Kjo është e rregulluar me kushtetutë. E jona është, eventualisht, me Rregulloren të themi se mund të marrë pjesë, por ne nuk mund ta autorizojmë.

Janë edhe një sërë vërejtjesh, që këtu janë shtuar, të natyrës redaktoriale. Ato nuk janë objekt i vërejtjeve të UNMIK-ut, kurse ky tekst ka të bëjë me vërejtjet e UNMIK-ut. Unë propozoj që kjo pjesë, do të thotë, prej amendamentit 8 deri në atë 11, të përfshihen në pakon e ndryshimeve që duhet të bëhen të natyrës redaktoriale, për të cilat janë bërë vërejtje. Ju siguroj se janë me dhjetëra, për të mos thënë – me qindra vërejtje të domos-

doshme që duhet të ndryshohen.

Liljana Keniq, tha se nuk mund të pajtohem me qendrimin e z.Bajrami dhe desha të pyes pse amendamentet tona nuk kanë hyrë në procedurë, edhe pse me kohë i kemi paraqitur më 23.10.2003. Mendoj se nuk është në rregull që, dikush të na refuzojë të drejtën në amendamente dhe në paraqitjen e amendamenteve. Në këtë drejtim, do ta bëjmë një vërejtje serioze në punën e tërë sekretarisë, së këndejmi edhe për juve, në fund të fundit. Për çdo rast, unë kisha propozuar që kjo të shtyhet për javën tjetër dhe amendamentet tona të gjenden para deputetëve tjerë.

Bujar Dugolli tha se ne kemi votuar



Rregulloren disa muaj përpara, e cila nuk bie ndesh as me Kornizën Kushtetuese, as me punën e Kuvendit të Kosovës. Unë e kuptoj se Komisioni u mundua t'i përgjigjet në njëfarë mënyre ankesave që i ka bërë Zyra Ligjore e UNMIK-ut, por mendoj se ne nuk duhet t'i pranojmë as këto propozime të Komisionit, sepse deformatojmë Rregulloren tonë që e kemi miratuar njëherë dhe ne nuk mund të kthehemi prapa. Domethënë, këtë propozim ne nuk do ta mbështesim dhe kërkojmë që të mos mbështetet, sepse e dëmtojmë vetë Rregulloren që e kemi nxjerrë disa muaj më herët.

Vërejtjet nuk ndërrojnë
esencialisht asgjë

Sabri Hamiti theksoi se Komisioni ka punuar në mënyrë shumë profesionale sepse ka shqyrtuar propozimet që kanë ardhur edhe të një grupi par-

lamentar edhe ato vërejtje famoze që vijnë nga UNMIK-u rreth kësaj Rregulloreje dhe unë mendoj se ka bërë shumë mirë që njëherë e përgjithmonë i ka shqyrtuar dhe ka dhënë një version.

Unë për vete, por edhe në emër të Grupit Parlamentar, mendoj që këto vërejtje janë të përballueshme dhe nuk ndërrojnë esencialisht kurrgjë, esencialisht po them. Unë i kam studiuar vetë për vete, me vete e kam Rregulloren dhe jam përpjekur t'i shoh të inkorporuara dhe tekstualisht qysh duken këto dhe ku duken dhe më është dukur se diku-diku sqarohen diçka. Plus kësaj, unë shoh që në këto vërejtje bile janë marrë disa formulime që janë propozuar, formulime

edhe nga grupi i "Kthimit" edhe nga ai farë komisioni i UNMIK-ut.

Atje ku zotni Hydajet Hyseni thotë që hyhet në problem të deliktit verbal, nuk është Hydajet, ky thotë: veprime, veprime, s'është puna vetëm të flasim. Domethënë, është shumë më thellë problemi i këtij formulimi. Unë do të thosha që formulimi është edhe më i fortë se sa po mendoni ju. Kështu që, nëse këto nuk do të votohen si të tëra, siç po shihet, edhe unë atëherë jam që të votohen një për një dhe ta kryejmë punën. S'ka kurrfarë arsyeje, bile është shumë fatlume, shumë mirë që definitivisht ta kryejmë këtë punë dhe mos të flasim me gjysmë fjale për këtë Rregullore dhe definitivisht të rregullohet sot dhe të dihet cila është në fuqi. Ne vijim Kuvendi aprovoi propozimin e Komisionit për të gjitha vërejtjet dhe amendamentet në tërësi në këtë Rregullore.

Një veprim që vështirëson tej mase pjesëmarrjen në proceset e shtensionimit të situatës

Para se të fillojë shqyrtimi i materialeve sipas rendit të ditës, në mbledhjen e 23 tetorit të Kuvendit të Kosovës, kryeparlamentari **Nexhat Daci** në emër të Parlamentit të Kosovës bëri një prononcim lidhur me ndalimin dhe arrestimin e komandantit të Trupave Mbrojtëse të Kosovës, gjeneral-lejtënant Agim Çeku, nga ana e organeve sllovene, duke theksuar se në vazhdimësi po krijohet një instabilitet i shtuar politik në Kosovë dhe këtë pa dëshirën dhe pa pjesëmarrjen e kosovarëve. «Ajo që për një vit e gjysmë si institucione u mundam ta bindim bashkësinë ndërkombëtare, se në Kosovë po funksionon tërë gama e pushtetia të një vendi fqinj, nuk jepte rezultate të duhura. Këtë edhe në Seancën plenare të Vienës u mundova ta dokumentoj dhe fatkeqësisht u pa që kisha të drejtë.

Me fletarrest të një gjykate inekzistente, të një pushteti inekzistent në Kosovë, u ndal dhe u arrestua prijësi i një prej institucioneve, siç e quajmë ne vitale dhe më të rëndësishme të Kosovës. Kjo ishte hera e dytë që prijësit e Kosovës të poshtërohen dhe me këtë, jo ata dhe dinjiteti i tyre individual, por Kosova, e kaluara e saj, e tashmja dhe e ardhmja e Kosovës. Megjithatë, pas një nate të të gjithë juve kolegë të nderuar dhe të Kosovës, është lajm i mirë që brenda bashkësisë ndërkombëtare ka njerëz shumë të përgjegjshëm. Dhe, mirënjohjet tona u drejtohen të gjithë atyre që u munduan të ndikojnë pozitivisht, në veçanti mirënjohja i takon zotit Hollkeri për shkak të angazhimit të tij të vendosur, këmbëngulës dhe frytdhënës. Kjo lë një vakum për institucionet tona, në veçanti për Parlamentin: – çka më tutje? Sfidat janë shumë të mëdha. Përgjegjësitë tona të marra nga elektorati janë

shumëfishuar dhe ne duhet të sillemi konform atyre përgjegjësi. Ne, me rreziqe të caktuara, me çmime të larta, por në interes të Kosovës, me bindje të thellë që në interes të Kosovës dhe qytetarëve të saj, ishim në anien e paqes me bashkësinë ndërkombëtare. Ne dëshirojmë të mbetemi bashkërisht në atë anije, për hirë të ardhmërisë së projektuar, të plani-

të cilët mbrohet dinjiteti dhe identiteti i institucioneve të Kosovës, i njerëzve që iu prijnë proceseve demokratike në Kosovë. Nuk u gjend zgjidhje. Kësaj radhe arsyet janë shumë më të fuqishme që të kërkojmë, që të kërkojmë dokumente diplomatike udhëtimi për të gjithë ata që u paraprijnë proceseve demokratike në Kosovë, dhe në qoftë se bashkësia ndërkombëtare, si

KUVENDI I KOSOVËS

23 tetor 2003

Prishtinë

Kuvendi i Kosovës, i shqetësuar për arrestimin e Komandantit të Trupave Mbrojtëse të Kosovës, gjeneral lejtënant Agim Çeku, si dhe për arrestimet e mëparshme të përfaqësuesve të institucioneve të Kosovës, e të qytetarëve të saj, duke kundërshtuar funksionimin e organeve paralele serbe në Kosovë e në Serbi, të emërtuara si gjykata të Kosovës, miraton këtë

DEKLARATË

Kuvendi i Kosovës i konsideron të pavlefshme të gjitha fletëarrestet, vendimet gjyqësore dhe ekzekutimet e këtyre vendimeve që bëhen nga institucionet e Serbisë dhe nga organet gjyqësore paralele serbe, të cilat funksionojnë në territorin e Kosovës e të Serbisë dhe kanë të bëjnë me qytetarët e Kosovës.

Kuvendi kërkon nga institucionet ndërkombëtare në Kosovë dhe jasht saj, duke përfshirë Interpolin dhe Evropolin, që të mos i njohin këto vendime dhe fletëarreste serbe kundër qytetarëve të Kosovës, sepse Kosova është nën jurisdiksionin e Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe ka institucionet e veta demokratike.

Kuvendi kërkon nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm, zoti Hary Hollkeri që të ndërmarrë veprime urgjente për zhbërjen e institucioneve paralele në Kosovë.

Kuvendi i Kosovës proteston ndaj veprimit të organeve shtetërore të Sllovenisë lidhur me arrestimin e djeshëm të Komandantit të Trupave Mbrojtëse të Kosovës, gjeneral lejtënant Agim Çeku.

Teksti i deklaratës u përkrah nga deputetët, me një votë kundër.

(Teksti i plotë i Deklaratës)

fikuar dhe në strategji të paraparë të popullit të Kosovës. Por, jo më me këto sjellje», theksoi profesor Daci. Unë, në fillim të mandatit tim, kam kërkuar nga bashkësia ndërkombëtare që prijësit e institucioneve të Kosovës duhet të kenë dokumente udhëtimi me

mision i saj në Kosovë, nuk është në gjendje ta sigurojë këtë, ne duhet seriozisht t'i rishqyrtojmë pozicionet tona, ose të kërkojmë zgjidhje që janë në frymë të përgjegjësi që i kemi dhe të detyrave që duhet t'i kryejmë para qytetarëve të Kosovës.

Shprehet kundërshti ndaj arrestimit të kreut të TMK-së, gjeneral - lejtënant Agim Çekut

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Nexhat Daci, priti në një takim mr. Anders Liden, drejtor politik pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme të Suedisë dhe Karin Hermarc, shefe e Zyrës Suedeze në Prishtinë. Duke folur për çështjen e arrestimit të gjeneral-lejtënant Agim Çekut në Slloveni, kryeparlamentari Daci me këtë rast shprehu kundërshtimin e tij ndaj arrestimit të kreut të TMK-së, institucion ky më i respektueshëm. Një veprim i këtillë po ndodh për të dytën herë me personalitete të institucioneve kosovare. Rasti i parë ndodhi me arrestimin e kryetarit të PDK-së, Hashim Thaçit në Budapest, madje duke u mbështetur në akuza të ngritura nga organet serbe edhe pasi Milosheviqi ka shkuar në Hagë. Kjo është edhe një dëshmi se Serbia vështirë po e kupton realitetin e ri në Kosovë.

Institucionet e Kosovës, theksoi në vijim profesor Daci, duhet të respektohen, duke ditur se ato veprojnë në bashkëpunim me UNMIK-un. Kryeparlamentari Daci shprehu njëkohësisht kundërshtimin e tij edhe kundër organeve sllovene, si dhe të tjerave që marrin parasysh akuza të tilla.

Jemi të interesuar për dialog me Unionin Serbi- Mali i Zi, por nga Serbia për fat të keq nuk vijnë sinjale të mira, sepse nga organet e saj që disa herë bëhen agresione kushtetuese ndaj Kosovës, theksoi kryeparlamentari Daci. Është fakt që Milosheviqi është në Hagë, por të gjitha levat e sigurimit të tij janë duke vepruar në Serbi dhe në Kosovë.

Kuvendi të reagojë në mënyrë institucionale

Në vijim mori fjalën **Bujar Dugolli**, i cili kërkoi që në këtë seancë si çështje e ngutshme, të përfshihet ngjarja e djeshme dhe Kuvendi të reagojë në mënyrë institucionale, jo përmes këshilltarëve, dhe njëkohësisht të kërkohet nga Qeveria e Kosovës që t'i dërgojë notë proteste Qeverisë së Sllovenisë, po ashtu edhe Qeverisë së Beogradit që t'i shuajë njëherë e përgjithmonë ato institucione paralele, që janë institucione kriminele, që janë të trashëguara nga periudha e Milosheviqit e deri më tash. Sa për një shembull, e ashtuquajtura gjykatë e qarkut e Prishtinës, që udhëheqet nga kriminelja Danica Marinkoviç, e cila

me urdhërin e vet në gjykatën hetuese, të paktën tre të burgosur politik i ka mbytur me torturë, si: Besnik Restelicën, Rexhep Bislimin, Cen Dugollin. Ajo është kryekriminele, e cila bën akuza ndaj njerëzve, ndaj veprimtarëve, ndaj bartësve të institucioneve që mundohen të instalojnë paqe dhe qetësi në Kosovë.

Provokacione të vazhdueshme

Berat Luzha, tha se jemi dëshmitarë të provokacioneve të vazhdueshme të pushtetit serb ndaj Kosovës, në këtë radhë edhe të organeve shtetërore të Sllovenisë. Grupi Parlamentar i PDK – së propozon që të bëhet një deklaratë, një protestë zyrtare drejtuar organeve shtetërore të Sllovenisë dhe të kërkohet nga zoti Hollkeri, që të ndërmarrë masat e fundit, më të ashpra, kundër institucioneve paralele të shtetit të Serbisë, të cilat i ka në Kosovë. Ju të gjithë e keni lexuar raportin e OSB-së, në të cilin flitet se të gjitha organet shtetërore të Serbisë, duke përfshirë edhe sekretariatit e punëve të brendshme të Serbisë funksionojnë në Kosovë. Madje, jo vetëm në Serbi, por edhe brenda në Kosovë. Është koha, është momenti që këto institucione të shuhën. Serbia vazhdon politikën e Milosheviqit ashtu siç ka qenë atëherë dhe nuk është e gatshme dhe nuk i plotëson kushtet për një dialog të mirëfilltë me Kosovën.

Rangjel Nojkiqi theksoi se unë, para së gjithash ,duhet të distancohem...Ju nuk flisni në emër të tërë Kuvendit të Kosovës, flisni për një shumicë në Parlament dhe , ju lutem, ju edhe ashtu silleni. Me rastin e shkuarjes në Vjenë edhe ju z. Rugova, gjithashtu e keni përfaqësuar një grup shumicë, por jo të gjithë, gjegjësisht jo tërë popullatën e Kosovës. Nuk mund të diskriminoni në këtë mënyrë, këtë e keni bërë edhe deri më tani, ta diskriminoni këtu një grupacion më të madh, i cili gjithashtu është mjaftë i rëndësishëm dhe që ka fituar besimin e një numri të caktuar të qytetarëve të Kosovës.

Flisni për atë se duhet të përgjigjen për krime të luftës, prandaj për krime të luftës duhet të përgjigjen të gjithë.

Ju e dini se në hapësirat e Kosovës kanë pësuar edhe serbet edhe shqiptaret edhe romet edhe gjithë të

tjerët. Prandaj, nëse ka të vuajtur atëherë ka edhe aso që janë përgjegjës për këtë. Është normale që shteti në të cilin jetojmë, para së gjithash të kërkojë ta mbrojë bashkësinë e vet në këto hapësira. Prandaj, t'i lëmë këto, në mënyrë që për këto gjykimin ta japi judikatura dhe Bashkësia ndërkombëtare. Kryetari i Kuvendit të Kosovës, **Nexhat Daci** theksoi se unë i kuptoj vështirësitë e Nojkiqit që nuk ka jetuar, nuk ka dashur të përfshihet në një sistem demokratik, prandaj edhe rregullat elementare të demokracisë, të shumicës demokratike nuk është në gjendje t' i kuptojë.

Kërkohe shfuqizim i të gjitha akteve që i ndërmerr Serbia ndaj qytetarëve të Kosovës

Sabri Hamiti, tha se këtu, para se të hapet rendi i ditës, u hap një temë, që ashiqare e hap aktualiteti konkret, një temë e dhembshme, që ka të bëjë me raportet tona me jashtë dhe me sjelljet ndaj njerëzve tanë, në këtë rast ndaj përfaqësuesve. Ju duhet ta dini sa është e egër kjo sjellje ndaj njerëzve, që i quajmë në zhargonin e përditshëm të zakonshëm, kur merr peshën dhe karakterin e këtillë ndaj personave përfaqësues.

Unë mendoj që është mirë të reagohej edhe kështu. Mirëpo, Kuvendi, si një organ shumë përgjegjës, edhe para zgjedhësve të vet, edhe para përfaqësimit politik të Kosovës – nëse do të marrë një qëndrim në formë të shkruar është mirë që të marrë qëndrim pak a shumë kësajsoj:

Kuvendi kërkon shfuqizimin e të gjitha akteve që i ndërmerr Serbia ndaj qytetarëve të Kosovës dhe ky shfuqizim, në formë të artikuluar me shkrim, t'u dërgohet qeverive evropiane, edhe Interpolit edhe Evropolit.

Dhe, kjo do të ishte, unë kujtoj, veprimi më i fortë institucional sesa ne të bisedojmë për rastet që ndodhin dhe për komentimin e tyre.

Në vijim kryetari dha një pauzë për të formuluar dokumentin në mbështetje të asaj që u paraqit nga grupet parlamentare në këtë seancë.

Pas puzës zonja **Nekibe Kelmendi** paraqiti para deputetëve një deklaratë – dokument të hartuar nga grupi i përbërë prej grupeve parlamentare.

